

UNIVERSITETI I EVROPËS
JUGLINDORE

FAKULTETI I SHKENCAVE DHE
TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE
Drejtimi: Zbatimi i TIK në Mësimdhënie



TEZË E MAGJISTRATURËS

Përdorimi i ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve

Rast studimi: Shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë

Kandidatja
Arjeta Ramadani

Mentori
Prof. Dr. sc. Jaumin Ajdari

Tetovë, Prill 2020

Lektoroi:

DEKLARATA E AUTORIT

Unë, Arjeta Ramadani, studente në Fakultetin e Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore në Universitetin e Europës Juglindore (SEEU) deklaroj se jam autore e këtij punimi.

Arjeta Ramadani

LISTA E SHKURTESAVE

AML	Arsimi i Mesëm i Lartë në Republikën e Kosovës
SHAML	Shkollë e Arsimit të Mesëm të Lartë
SMS	Short Message Sent
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
ADA	Americans with Disabilities Act
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

ABSTRAKTI

Gjatë dy dekadave të fundit në Kosovë, nuk ka pasur shumë hulumtime në lidhje me bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet shkollës dhe prindërve përmes ueb-faqeve zyrtare të shkollave. Ndërkaq në mbarë botën janë bërë shumë hulumtime që kanë të bëjnë me rëndësinë e komunikimit midis prindërve dhe shkollës përmes ueb-faqeve të shkollave dhe këto hulumtime tregojnë rëndësinë e këtij komunikimi për të gjitha palët dhe se marrëdhënia e partneritetit mes shkollës dhe prindërve japin përfitime të shumta. Përveç mënyrave të zakonshme të komunikimit si biseda individuale dhe mbledhjet e prindërve, mesazhet me shkrim, takimet jozyrtare, punëtoritë edukative, përfshirja e prindërve në procesin arsimor, mënyra më bashkëkohore e komunikimit me prindërit është nëpërmjet ueb faqeve të shkollave, ueb faqet e mësimdhënësve, e-mail adresat dhe mesazhet SMS. Qëllimi i hulumtimit është që të evidentohet nëse ueb-faqet e shkollave të Arsimit të Mesëm të Lartë në Republikën e Kosovës kanë përmbajtje që u mundësojnë nxënësve informim të mjetueshëm si dhe të krijojnë një frymë bashkëpunimi ndërmjet shkollës, prindërve dhe nxënësve. Qëllimi afatgjatë është të binden shkollat apo organet vendimmarrëse për të krijuar ueb-faqe zyrtare si dhe të azhurnojnë rregullisht ueb faqet me materiale të reja, të cilat do të rezultonin në një bashkëpunim cilësor mes shtëpisë dhe shkollës. Hulumtimi ka përfshirë të gjitha ueb faqet e shkollave private dhe publike të Arsimit të Mesëm të Lartë të Republikës së Kosovës.

ABSTRACT

Over the last two decades in Kosovo not much research has been done regarding co-operation and communication between school and parents through official school websites. Whereas globally many researches has been done regarding the importance of communication between parents and school through school websites and these researches shows the importance of this communication to all parties and that the relationship of partnership between school and parent provides lots of benefits. Apart of ordinary communication such as individual conversations and parent meetings, written messages, informal meetings, educational workshops, parents' involvement in the educational process, the most modern way of communication with parents is through the school websites, teachers' websites, e-mails and SMS messages. The aim of the research is to find out whether the websites of Upper Secondary Education schools in the Republic of Kosovo have content that enables nxënëss to gain enough information and create a spirit of cooperation between school, parents and nxënëss. The long-term goal is to persuade schools or decision-making bodies to create official websites and regularly update web sites with new materials that would result in a quality home-school collaboration. The research has included all websites of the private and public schools of the Upper Secondary Education of the Republic of Kosovo.

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATA E AUTORIT	3
LISTA E SHKURTESAVE	4
ABSTRAKTI	5
TABELA E PËRMBAJTJES.....	7
Kapitulli I	12
1. HYRJE	12
1.1. Qëllimi i hulumtimit.....	13
1.2. Objektivat e studimit.....	13
1.3. Metodologjia e hulumtimit.....	14
1.4. Rëndësia e punimit	15
1.5. Hipotezat e studimit	16
1.6. Pyetjet kërkimore	16
1.7. Struktura e temës.....	17
Kapitulli II.....	18
2. RISHIKIMI I LITERATURËS.....	18
2.1. Evoluimi i ueb faqeve edukative	18
2.2. Shtjellimi i përdorimit të ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve sipas këndvështrimit të autorëve të ndryshëm	20
Kapitulli III	32
3. PËRDORIM I UEB-FAQEVE SI PLATFORMË KOMUNIKIMI NË SHKOLLAT E ARSIMIT TË MESËM TË LARTË NË KOSOVË.....	32
3.1. Analizimi i përmbajtjes së ueb-faqeve në shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë	32
3.2. Analiza e anketimit me prindër	36
3.3. Komunikimi përmes ueb-faqeve në shkollat publike të Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë	45
3.4. Komunikimi përmes ueb-faqeve në shkollat private të Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë	51
Kapitulli IV	56
4. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	56
4.1. Konkluzionet	56
4.2. Rekomandimet	58
BIBLIOGRAFIA	60
SHTOJCA I.....	63
Pyetësor: Përdorimi i ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve	63
Rast studimi: Shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë	63

SHTOJCA II	67
Përdorimi i ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve. Rast studimi: Shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë	67
SHTOJCA III	69
Përdorimi i ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve. Rast studimi: Shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë	69

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Përparsitë dhe të metat e komunikimit përmes mediave elektronike (Tavas,, Nazor, & Bilac, 2011).....	19
Tabela 2. Kriteret për vlerësimin e ueb-faqeve të shkollave të AML.....	33
Tabela 3. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme për fëmijun tuaj nga shkolla?	38
Tabela 4. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme për fëmijun tuaj nga shkolla?	42
Tabela 5. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme nga shkolla?	45
Tabela 6. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme nga shkolla?	52

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Rezultatet e vlerësimit të ueb-faqeve të shkollave të AML	34
Figura 2. Në çfarë shkolle vijon mësimin fëmiju i juaj?.....	36
Figura 3. Në cilën klasë vijon mësimin fëmiju i juaj?	36
Figura 4. A ka shkolle e fëmijut tuaj ueb-faqe zyrtare?.....	37
Figura 5. A ka shkolle e fëmijut tuaj ueb-faqe zyrtare?.....	37
Figura 6. Sa shpeshë e vizitoni ueb-faqen e shkollës së fëmijut tuaj?	38
Figura 7. Cilat nga elementet e mëposhtme i përmban ueb-faqja e shkollës së fëmijut tuaj? ..	39
Figura 8. Ndikimi i komunikimit përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës.....	40
Figura 9. Si ka ndikuar komunikimi me shkollën përmes ueb-faqes zyrtare në aspektin e menaxhimit të kohës?	40
Figura 10. Në përgjithësi si e vlerësoni ueb-faqen e shkollës së fëmijut tuaj?	41
Figura 11. A mendoni se është e nevojme që shkolle e fëmijut tuaj të ketë një ueb-faqe zyrtare?.....	41
Figura 12. Cilat nga elementet e mëposhtme duhet t'i përmbajë ueb-faqja e shkollës së fëmijut tuaj?.....	42
Figura 13. Në rast se shkolle e fëmijut tuaj do të krijojë një ueb-faqe zyrtare, si do ta vlerësonit ndikimin e sajë?.....	43
Figura 14. A mendoni se komunikimi online me shkollën do të kishte efekt pozitiv në menaxhimin e kohës?.....	44
Figura 15. Në përgjithësi si do ta vlerësoni ueb-faqen e shkollës së fëmijut tuaj?.....	44
Figura 16. Pjesëmarrja e respondentëve në shkollat publike sipas klasëve.....	45
Figura 17. A mendoni se është e nevojme që shkolle e juaj të ketë një ueb-faqe zyrtare?.....	46
Figura 18. A do ta kishit shfrytëzuar ueb-faqen e shkollës për t'u konsultuar me mësimdhënësit rreth çështjeve mësimore?.....	46
Figura 19. Çka mendoni, cilat nga elementet e mëposhtme duhet t'i përmbajë ueb-faqja e shkollës tuaj?.....	47
Figura 20. Ne rast se shkolle juaj do të krijojë një ueb-faqe zyrtare, si do ta vlerësonit ndikimin e sajë në	48

Figura 21. A mendoni se komunikimi online me shkollën do të kishte efekt pozitiv në menaxhimin e kohës?.....	48
Figura 22. Komunikimi përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës a do t'iu kishte stimuluar që të keni arritje më të lartë në mësim-nxënie?	49
Figura 23. Si do ta vlerësonit ndikimin e ueb-faqes zyrtare të shkollës në motivimin tuaj? ...	49
Figura 24. Si do ta vlerësonit ndikimin e komunikimit mësimdhënës-prind-nxënës përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës në suksesin tuaj në mësim?	50
Figura 25. Si do ta vlerësonit në përgjithësi komunikimin me shkollën përmes ueb-faqes?...	50
Figura 26. Sa shpesh e vizitoni ueb-faqen e shkollës?.....	51
Figura 27. Informatat që merren më së shpeshti nga ueb faqet e shkollave private të AML ..	51
Figura 28. Qka mendoni se i mungon ueb-faqes së shkollës suaj	52
Figura 29. Cilat nga elementet e mëposhtme i përmbanë ueb-faqja e shkollës suaj?.....	53
Figura 30. A e shfrytëzoni ueb-faqen e shkollës për t'u konsultuar me mësimdhënësit rreth qështjeve mësimore?	54
Figura 31. Komunikimi përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës ka ndikuar në:.....	54
Figura 32. Sa mendoni se ueb-faqja i plotëson nevojat e kohës?	55
Figura 33. Në përgjithësi si e vlerësoni ueb-faqen e shkollës suaj?	55

Kapitulli I

1. HYRJE

Në dekadat e fundit është rritur nevoja për komunikim më cilësor ndërmejt shkollës, nxënësve dhe prindërve. Duke u nisur nga fakti që dinamika jetësore gjithnjë e më shumë e kufizon mundësinë e komunikimit të drejpërdrejtë ndërmjet njerëzve, andaj komunikimi ndërmjet prindërve, nxënësve dhe shkollës ka nevojë për një alternativë të re. Këtë alternativë më së lehti e mundëson aplikimi i teknologjisë së komunikimit përmes platformave të ueb komunikimit. Për këtë arsye komunikimi përmes ueb-faqeve zyrtare të shkollave të Arsimit të Mesëm të Lartë në Republikën e Kosovës është përzgjedhur si subjekt studimi.

Ideja është që të hulumtohet se a kanë SHAML në Republikën e Kosovës një komunikim të mirëfilltë ndërmjet shkollës, nxënësve dhe prindërve të tyre përmes ueb-faqeve duke marrë në konsideratë edhe moshën delikate të nxënësve të këtij niveli arsimorë ku më shumë duhet t'i kushtohet kujdes parandalimit të zhvillimit të dukurive negative që janë duke u përhapur çdo ditë e më shumë dhe tërheqjes së vëmendjes në mësim-nxënie efektive.

Në këtë kontekst një ueb-faqe adekuate e shkollës që përmban informacione të bollshme dhe me kohë mbi aktivitetet e shkollës, aktivitetet e nxënësve, vijueshmërinë e tyre, suksesin dhe arritjet e tyre, materiale mësimore, mundësi të mësimi nga distanca, qasje të sigurt të përdoruesve ku në të njëjtën kohë edhe prindërit janë të përfshirë në këtë proces, mendojmë se është një zgjidhje e qëndrueshme e problemit të komunikimit shkollë-nxënës-prind.

Bashkëpunimi midis prindërve dhe shkollave është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe ofron përfitime të shumëllojshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin arsimor. Një partneritet midis prindërve dhe mësimdhënësve krijon marrëdhënie të mira pasi që të gjithë partnerët i prezantojnë kompetencat e tyre në edukimin e fëmijës. Bashkëpunimi mes prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve duhet të jetë i formës më të mirë të mundshme për të arritur rezultate të jashtëzakonshme.

Për ta kuptuar më afër komunikimin shtëpi-shkollë përmes ueb-faqeve zyrtare të shkollave e kemi realizuar një anketim me prindërit dhe nxënësit e SHAML në Republikën e Kosovës. Anketimi me prindër është realizuar përmes formës elektronike nga platforma Google Forms ku vegëza e kësaj forme elektronike është shpërndarë tek publiku përmes rrjeteve sociale si dhe formave tjera të komunikimit përmes internetit. Gjithashtu një pjesë e pyetësorëve u janë shpërndarë në formë fizike prindërve të nxënësve me ndihmën e mësimdhënësve të shkollave të mesme të larta në Kosovë dhe rezultatet e tyre janë regjistruar në formën digjitale për t'i

grumbulluar të gjitha rezultatet në një vend. Ndërkaq anketimi me nxënësit është realizuar vetëm përmes pyetësorëve të shpërndarë në formë fizike mbrenda objekteve shkollore.

Të dhënat e mbledhura nga anketimi i lartpërmendur tregojnë se shkollat publike të Arsimit të Mesëm të Lartë nuk kanë ueb-faqe zyrtare ndërsa ato private kanë ueb-faqe zyrtare por për nga aspekti i përmbajtjes së tyre kanë ende hapësirë për përmirësim.

Nga ajo që u përmend më lartë mendojmë se përmes këtij hulumtimi kemi kontribuar sado pak në arritjen e një zgjidhjeje për implementimin e komunikimit bashkëkohor përmes ueb-faqeve zyrtare të shkollave në nivelin e Arsimit të Mesëm të Lartë në Republikën e Kosovës. Natyrisht që mbetet hapësirë për studime të mëtutjeshme edhe nga studiues tjerë në këtë fushë edhe për nivelet tjera të arsimit në mbarë vendin.

1.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij studimi është që të hulumtojmë se a kanë shkollat e arsimit të mesëm të lartë ueb-faqe zyrtare dhe se a komunikojnë prindërit e shkollave të mesme të larta në Kosovë me shkollën e fëmijëve të tyre përmes ueb-faqeve zyrtare të shkollës si një platformë digjitale e komunikimit modern si dhe se si ueb-faqet ndikojnë në komunikimin ndërmjet prindërve, mësimeve dhe nxënësve. Gjithashtu edhe hulumtimi dhe vlerësimi i aspektit përmbajtësorë të ueb-faqeve është pjesë e këtij studimi për ta kuptuar se a u ofrojnë shkollat materiale dhe informata të mjaftueshme dhe me kohë nxënësve dhe prindërve të tyre.

1.2. Objektivat e studimit

Ky punim ka për synim të hulumtojë se a përdoret komunikimi shtëpi-shkollë përmes ueb-faqeve zyrtare në shkollat e arsimit të mesëm të lartë në Kosovë. Gjithashtu të vlerësohet se çfarë dhe si janë paraqitur informacionet relevante në ueb-faqet e tyre dhe sa i plotësojnë kriteret e një komunikimi bashkëkohor.

Objektivat parësorë të punimit janë:

- Analizimi i përparësive dhe të metave të komunikimit përmes ueb-faqeve të shkollës
- Identifikimi i mënyrave të komunikimit në SHAML
- Krahasimi i mënyrave të komunikimit shkollë-nxënës-prindër ndërmjet sektorit privat dhe publik të AML

- Analizimi i ndikimit të komunikimit efektiv dhe të shpejtë përmes ueb-faqeve në motivimin dhe suksesin në mësim-nxënie
- Gjetja e mënyrave të reja dhe bashkëkohore të komunikimit ndërmjet shkollës, nxënësve dhe prindërve
- Identifikimi i kërkesave të prindërve për mënyrën e komunikimit me shkollën
- Përshkrimi i konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve në lidhje me përdorimin e ueb-faqeve zyrtare të SHAML në Republikën e Kosovës.

1.3. Metodologjia e hulumtimit

Studimet e thelluara mbi përdorimin e ueb-faqeve në shkollat e arsimit të mesëm të lartë në vendin tonë janë të limituara. Literatura botërore në këtë fushë është relativisht e pasur edhe shumë atraktive për studiues. Hulumtimi është përqendruar mbi faktin se a ka platformë komunikimi përmes ueb-faqeve të shkollave të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë. Për shkollat të cilat kanë ueb-faqe zyrtare janë analizuar përmbajtjet e tyre si dhe a janë prindërit të përfshirë në këtë proces. Për këtë hulumtim kemi përdorur disa metoda kërkimore si në vijim:

– Metoda empirike

Kjo metodë kryesisht përdoret për të identifikuar aspektet kuantitative të gjendjes faktike në lidhje me çështjen në fjalë.

– Metodatat statistikore

Është realizuar me nxënës dhe prindër të nxënësve të AML ku janë mbledhur të dhëna nga pyetësorët e krijuar. Anketimi është zhvilluar në shkolla publike dhe private të AML në Republikën e Kosovës. Gjithsej janë anketuar 550 nxënës ku 72% prej tyre janë nga shkollat publike dhe 28% nga shkollat private të AML.

Të dhënat e marra nga ky anketim janë regjistruar në një bazë të të dhënave dhe përpunimi i rezultateve dhe analizat kuantitative janë bërë përmes aplikacionit Microsoft Excel 2016.

– Metoda induktive

Qasja induktive, e njohur edhe si arsyetimi induktiv, fillon nga vëzhgimet dhe pastaj teoritë propozohen në përfundim të procesit të hulumtimit si rezultat i vëzhgimeve. Hulumtimi induktiv përfshin kërkimin e modelit nga vëzhgimi dhe zhvillimin e shpjegimeve - teorive - për ato modele përmes një serie hipotezash. Pra si subjekt i vëzhgimit kanë qenë shkollat e arsimit të mesëm të lartë në Kosovë ku nga rezultatet e marra përmes vëzhgimit janë ngritur disa hipoteza dhe në fund janë nxjerrë edhe konkluzione dhe rekomandime rreth përdorimit të ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve. Në qasjen induktive janë përdorur metoda kuantitative të hulumtimit ku është realizuar një anketim me nxënës të shkollave të arsimit të mesëm të lartë.

– Metoda krahasuese

Është përdorur për të bërë krahasimin e përdorimit të ueb-faqeve në shkollat e AML të Republikës së Kosovës si dhe vendeve tjera më të zhvilluara.

– Metoda analitike

Është përdorur për analizën e rezultateve të fituara si dhe sjelljen e konkluzioneve dhe rekomandimeve në bazë të atyre rezultateve.

1.4. Rëndësia e punimit

Për të pasur një cilësi të mirë në menaxhimin e shkollës si dhe për të arritur nivele të larta të suksesit të nxënësve, faktori më i rëndësishëm është krijimi i raporteve sa më të afërta ndërmjet personelit të shkollës, nxënësve dhe prindërve të tyre. Këto raporte mund të jenë të dobishme nëse ekziston një komunikim i mirëfilltë. Mosinformimi në kohë apo mungesa e informatave në procesin e komunikimit shkakton pakënaqësi, parregullsi, jo-seriozitet dhe si pasojë mund të shkaktoj edhe konflikte. Andaj ky aspekt ka nevojë të studijohet sidomos në shkollat e arsimit të mesëm të lartë duke marrë në konsideratë edhe moshën senzitive të nxënësve të këtij niveli arsimorë.

1.5. Hipotezat e studimit

Studimi merr përsipër të ballafaqojë dhe vërtetojë hipotezat e përcaktuara si më poshtë, që përbëjnë thelbin e këtij punimi:

- H1. Shkollat private të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë janë më të avancuara në komunikimin shtëpi-shkollë përmes platformave të ueb-faqeve se sa shkollat publike të arsimit të mesëm të lartë.
- H2. Në përgjithësi në shkollat publike të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë nuk ka komunikim dhe shkëmbim informatash ndërmjet mësimeve, nxënësve dhe prindërve përmes ueb-faqeve zyrtare.
- H3. Komunikimi përmes ueb-faqeve zyrtare ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve.
- H4. Komunikimi përmes ueb-faqeve zyrtare përmirëson komunikimin nxënës-mësimeve-prind dhe lehtëson informimin dhe përfshirjen e prindërve në aktivitetet e shkollës.
- H5. Komunikimi përmes ueb-faqeve zyrtare e rrit nivelin e sigurisë në shkollë.
- H6. Komunikimi përmes ueb-faqeve zyrtare stimulon arritje më të lartë në mësim-nxënie.

1.6. Pyetjet kërkimore

Në lidhje me hipotezën H1 do të bëhet një analizë e detajuar individuale e ueb faqef të secilës shkollë private të arsimit të mesëm të lartë si dhe të shkollave publike të të njëjtit nivel të arsimit duke u bazuar në pyetjen hulumtuese se a janë më të avancuara shkollat private apo ato publike të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë në aspektin e komunikimit përmes platformave të ueb-faqeve zyrtare. Nga rezultatet e nxjerra to të konkludojmë mbi vërtetësinë e hipotezës.

Për të vërtetuar hipotezën H2 do të bëj një hulumtim të të gjitha shkollave të mesme të larta në të gjithë Kosovën dhe do të vlerësoj nëse kanë ueb faqe ose jo, çfarë përmbajtje kanë ato dhe a i plotësojnë kërkesat për një komunikim efektiv ndërmjet mësimeve, nxënësve dhe prindërve përmes ueb-faqeve zyrtare.

Për të vërtetuar hipotezën H3 do të përdoren rezultatet e hulumtimeve shkencore për të konkluduar se si ndikon komunikimi përmes ueb-faqeve në motivimin e nxënësve, sa e lehtëson informimin dhe përfshirjen e prindërve në aktivitetet e shkollës, çfarë ndikimi ka ky

komunikim në rritjen e sigurisë në shkollë dhe cili është efekti në arritshmërinë e nxënësve në mësim.

1.7. Struktura e temës

Teza është organizuar në katër kapituj me përmbajtje si në vijim:

1. Kapitulli i parë përfshinë një hyrje mbi rëndësinë e zbatimit të komunikimit përmes ueb-faqeve zyrtare në shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë. Gjithashtu në këtë kapitull paraqitet gjendja momentale e një komunikimi të tillë duke i identifikuar problemet aktuale, objektivat e studimit, metodologjinë e hulumtimit, rëndësinë dhe rezultatet e pritshme nga hulumtimi. Po ashtu ky kapitull e shtjellon temën përmes ngritjes së hipotezave dhe pyetjeve kërkimore dhe e sqaron edhe strukturën e këtij hulumtimi.
2. Kapitulli i dytë paraqet rishikimin e literaturës duke shtjelluar përdorimin e ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve sipas këndvështrimit të autorëve të ndryshëm.
3. Kapitulli i tretë paraqet analizën e përmbajtjes së ueb-faqeve në shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë, gjithashtu paraqet edhe rezultatet e nxjerra nga anketimet e realizuara. Për të pasur një pasqyrë më të qartë se në cilat shkolla ka komunikim më të mirë apo në cilat ka mungesë të komunikimit shtëpi-shkollë përmes ueb-faqeve, rezultatet janë paraqitur ndaras për shkollat publike dhe ato private të AML. Gjithashtu janë paraqitur edhe rezultatet e nxjerra nga anketimi me prindër të nxënësve të AML.
4. Kapitulli i katërt përfshinë konkluzionet dhe rekomandimet. Në këtë kapitull kemi arritur të u japim përgjigje pyetjeve të ngritura të këtij hulumtimi dhe kemi arritur të konkludojmë mbi hipotezat e ngritura të këtij studimi. Si rrjedhojë kemi shqyrtuar se ku qëndron niveli i komunikimit përmes ueb-faqeve në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, sa efektiv është ky komunikim, roli i tij, format dhe mënyrat e përmirësimit të këtij komunikimi përmes rekomandimeve të dhëna.

Kapitulli II

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1. Evoluimi i ueb faqeve edukative

Evolucioni digjital që po ndikon në transformimin e përgjithshëm të shkollave po ndikon gjithashtu edhe thellësisht në rolin e ueb-faqeve të shkollave, duke e zhvendosur ueb-faqen nga pozicioni i saj dytësorë në atë parësorë dhe kritik për aktivitetet e përditshme të shkollës, procesin mësimorë dhe në rritjen e performancës dhe produktivitetin.

Ueb-faqja e shkollës mundëson që të sigurojë një platformë për t'i përfshirë të gjithë prindërit, mësimdhënësit dhe nxënësit në promovimin dhe shfaqjen e aktiviteteve të shkollës. Ueb-faqja mund të lehtësojë komunikimin, shkëmbimin e informacioneve dhe ideve, gjithashtu edhe në shkëmbimin dhe krijimin e njohurive. Më e rëndësishme është që ueb-faqja e shkollës mund të lehtësojë praktikën bashkëpunuese dhe të përmirësojë përvojat dhe rezultatet e të nxënit dhe mësimdhënies (Taddeo & Barnes, 2016).

Në shkollat tradicionale ueb-faqja është parë si një nga pjesët shumë diskrete të shkollës, kryesisht periferike për mësimet e përditshme.

Brenda shkollave të digjitalizuara, ueb-faqet janë të lehta në përdorim, dinamike, gjithnjë në zhvillim, janë thelbësore për pothuajse çdo aktivitet, përfshirë mësimin e shkollës 24/7/365.

Në të vërtetë pa atë ueb-faqe shkollat nuk mund të krijojnë ekosistemin e tyre digjital të dëshiruar dhe të realizojnë me sukses vizionin e tyre arsimor dhe digjital.

Shkollat duhet të pranojnë që zhvillimi dhe mirëmbajtja e ueb-faqeve zyrtare nuk mund të bëhet pa investime të përkushtuara dhe angazhim të burimeve njerëzore dhe financiare. Gjithashtu duhet të pranohet që të gjitha burimet dhe ekspertizat e nevojshme për të zhvilluar dhe mirëmbajtur një ueb-faqe shkollë mund të mos jenë të disponueshme brenda një komuniteti shkollor. Në disa raste mund të kërkohej kontraktim i shërbimeve nga kompani të jashtme për zhvillim dhe mirëmbajtje të ueb-faqeve dhe masa në të cilën ndodh kjo varet nga kompleksiteti dhe natyra e ueb-faqes dhe ka të ngjarë të ndryshojë gjatë gjithë jetës së ueb-faqes. Çdo transferim i jashtëm i shërbimeve të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së ueb-faqeve do të duhet të balancohet me kujdes me kontributin dhe angazhimin aktiv nga komuniteti i shkollës. Kjo do të shmangë komprometimin e një rëndësie, do të ruajë një ndjenjë të pronësisë dhe do të sigurojë që çdo agjendë dhe ndryshime të propozuara nga zhvilluesit e ueb-faqeve janë

mbështetur nga misioni i shkollës, nevojat e komunitetit të shkollës dhe më gjerësisht, nga parimet e shëndosha të arsimit (Taddeo & Barnes, 2016).

Në dy dekadat e fundit ueb-faqet e shkollave kanë qenë kryesisht sipërfaqësore apo më tepër e karakterit informues për punën e përditshme të shkollës dhe në veçanti mësimet e saj. Ka qenë kryesisht një burim statik informacioni dhe një mjet marketingu.

Ueb-faqet e shkollave u sigurojnë prindërve materiale të dobishme si këshilla arsimore, detyra shtëpie, e-mail ose menyja e lokaleve të shkollave dhe zgjerojnë kufijtë e komunikimit midis shtëpisë dhe shkollës në 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Kjo u lejon prindërve kalendarin e tyre ditor që nuk lejon vizita të rregullta në shkollë dhe ndërveprim ballë për ballë me fëmijën ose mësimdhënësin e tyre për të qenë më të informuar për atë që po ndodh në shkollë. Interneti bëhet një mjet i shkëlqyeshëm për lidhjen e shtëpisë dhe shkollës.

Pavarësisht nga shumë shkolla që sot kanë ueb-faqen e tyre , jo të gjitha janë të rëndësishme për komunikimin e prindërve dhe mësimdhënëseve. Hulumtimet e kaluara kanë treguar se struktura dhe përmbajtja e ueb-faqeve të shkollave duhet të planifikohen dhe zhvillohen me kujdes. (Tavas,, Nazor, & Bilac, 2011)

Tabela 1. Përparësitë dhe të metat e komunikimit përmes mediave elektronike (Tavas,, Nazor, & Bilac, 2011)

Përparësitë	Të metat
Informacionet merren çdo ditë për fëmijun	Të dy prindërit dhe mësimdhënësit duhet të kenë njohuri të punës në kompjuter
Transmetim i shpejtë i informacionit	Të gjithë pjesëmarrësit (prindërit, mësimdhënësit) duhet të kenë qasje në internet
Nuk kufizohet nga koha dhe vendi	Puna shtesë për mësimdhënësit (përditësimi i rregullt i të dhënave)
Kursim kohe për prindërit	Takime të rralla midis prindërve dhe mësimdhënëseve
Kursim kohe për mësimdhënësit kur dërgohen informacione të përgjithshme	Mungesa e komunikimit ballë për ballë
Prindërit vijnë në shkollë të përgatitur, temat për biseda janë edukative	Shpenzimet financiare për prindërit kur dërgojnë mesazhe SMS
	Abuzimi i mundshëm (fjalëkalimi)

2.2. Shtjellimi i përdorimit të ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve sipas këndvështrimit të autorëve të ndryshëm

Revista skandinave e studimeve në politikën arsimore publikoi studimin e autorit (Gu, 2017) me titull “Using school websites for home–school communication and parental involvement?”. Ky studim që u bë në disa komuna të Suedisë erdhi në konkludim që “Teknologjia duhet të përdoret për të mbështetur përfshirjen e prindërve përmes ueb-faqeve. Ajo mund të përdoret në mënyrë më optimale për të arritur qëllimin e përfshirjes së të gjitha familjeve duke mos paraqitur ndonjë problem edhe pse fluksi i përdoruesve mund të ishte i madh. Duhet të theksohen përparësitë që ka teknologjia përmes ueb-faqeve të cilat përmes burimeve të arritshme, metodave fleksibile dhe interaktive bëjnë integrimin e prindërve në ambientin edukativo-arsimor. Shkollat si institucione të larta të arsimit duhet të zhvillojnë mundësi të komunikimit të dyanshëm dhe kanale të ndërveprimit në mes shtëpisë dhe shkollës, kjo përmes ueb-faqeve të cilat përdoren për të rritur transparencën dhe mirëkuptimin e partneritetit prind-mësimdhënës në një mjedis jo verbal. Ky studimi tregon një nevojë për të marrë parasysh diversitetin kulturor në ndërtimin e ueb-faqeve shkollore. Pra, një ueb-faqe shkollore duhet të jetë një mënyrë e lirë dhe efikase e cila nxjerr në pah diversitetin kulturor që ka shkolla. Kjo do ta prezentonte shkollën në mënyrën më të duhur dhe të saktë, si dhe do t'i bënte prindërit të ndjehen të vlerësuar dhe do të rriste interesimin e tyre më shumë. Nëse një ueb-faqe është e vështirë për t'u përdorur, jo e qartë dhe me gabime, atëherë këta prindër do të zhgënjeheshin, nuk do të kishin më burime arsimore dhe sociale të disponueshme, gjë që mund t'i parandalojë ata të mbështesin mësimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre.”

(Laho, 2019) “Enhancing School-Home Communication through Learning Management System Adoption: Parent and Teacher Perceptions and Practices” është artikull i publikuar në “School Community Journal”. Autori konkludonë që “Ueb-faqja e quajtur Schoology u vlerësua shumë nga të gjithë ata prindër që e panë rëndësinë e saj duke zbuluar opcionet se si mund ta monitorojnë fëmijën e tyre në aktivitetet shkollore, ata gjithashtu rekomanduan mundësi shtesë për shkëmbimin e informacionit përmes sistemit të menaxhimit të mësimnxënies. Autori adreson që këto sisteme janë alternativë shumë e mirë për tu përdorur nga prindërit që gjatë ditës janë të stër-ngarkuar. Teknologjia përbën një pjesë të rëndësishme pasi që mundëson përfshirjen e prindërve në jetën shkollore të fëmijëve të tyre. Këtë e mundësojnë sistemet për menaxhimin e mësimnxënies. Sidoqoftë, grupet që e pranojnë këtë

zhvillim teknologjik duhet të ecin përpara me qëllime të qarta dhe mundësi të mjaftueshme të zhvillimit të personelit dhe prindërve.”

Sa i përket rëndësisë së një forme të re të komunikimit thuhet edhe në hulumtimin e bërë nga (Negrete, 2017) me titull “Blooming Relationships: Increasing Communication Between Parents and Teachers” Autorja konkludon që “Të mos them të gjithë, shumica e prindërve punojnë dhe për shkak të punës ata ndonjëherë nuk kanë mundësi të ndajnë kohë për të marrë pjesë në shumë në aktivitete që ndërlidhen me statusin e nxënësve në mësim apo në shkollë. Zbatimi i një forme tjetër të komunikimit e që mund të jetë një ueb-faqe shkollë, që mund të qaset direkt nga telefoni përmes internetit e ku ata prindër të brengosur mund t’i përcjellin të gjitha të bëmat e fëmijëve të tyre bashkë me rekomandimet e mësimdhënësve. Kjo është një ndihmesë e madhe në kohën e sotme e cila jep ndjenjë rehatie se femija i tyre është duke vazhduar mirë.”

Rëndësinë e teknologjisë si mjet komunikimi e ka theksuar edhe (Kraft, 2017) në “Educational Leadership” me titull “Engaging parents through: better communication systems”. Aty autori konkludon që “Shkollat me gjithë autoritetin, kanë edhe përgjegjësi ndaj gjithë pjesëtarëve që bëjnë pjesë në komunitetin shkollorë”. Ato duhet të mbledhin rregullisht preferencat e përditësuara të prindërve në lidhje se kur ata preferojnë të komunikojnë me mësimdhënësit, si dhe në çfarë forme ata dëshirojnë. Kjo mund të arrihet përmes teknologjisë së re dhe prindërve vullnetarë të cilët shërbejnë edhe si koordinatorë të angazhimit familjar. Pra, siç po theksohet, drejtuesit e shkollave luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e komunikimit mësimdhënës-prindër. Teknologjia digjitale duhet të jetë një pjesë e pandashme dhe e qëllimshme e infrastrukturës të komunikimit në shkolla. Për dallim nga qasja në internet me shpejtësi të madhe, pothuajse cdo i rritur në SHBA ka një telefon celular, pavarësisht nga statusi socio-ekonomik. Kjo do të thotë se shumica e prindërve të nxënësve në shkolla kanë telefon dhe kjo është një ndihmesë e madhe nga ana e tyre sepse në një ueb-faqe mund të qasesh prej kudo, mjafton të ketë internet.”

Pse një ueb-faqe është aq e rëndësishme për mbarëvajtjen e shkollës dhe përparimin e nxënësve në mësim duke përfshirë prindërit në proces, potencohet në artikullin “Using school websites to support parent engagement” nga (Piper, 2012). Aty autori konkludon se “Një ndër opsionet që nuk duhet të anashkalohet në dizajnimin e një ueb-faqeje është mundësia e zgjedhjes së përkthimit të përmbajtjes së ueb-faqes në shumë gjuhë e sidomos në gjuhët amë të nxënësve që shkolla strehon. Kjo jo që është një ndihmesë për nxënësit por është ndihmesë edhe për prindërit e tyre sepse me këtë alternativë ata do të mbështeteshin në përdorimin e lehtë të ueb-

faqes. Mundësia në Google Translate mund të jetë një ndër zgjidhjet si i integruar në ueb-faqen e shkollës. Ueb-faqja siguron informacione dhe algoritma se si familjet mund të ndihmojnë fëmijët e tyre në shtëpi me detyrat e shtëpisë dhe aktivitetet që lidhen me kurrikulën shkollore. Secili mësimdhënës mund të postojë udhëzimet dhe pritjet e tij nga nxënësit në sektorin e tij të caktuar në ueb-faqe. Mësimdhënësi gjithashtu mund të postojë detyra, video, materiale mbështetëse që ndërlidhen me temat e shpjeguara në klasë, kuriozitete e shumë e shumë gjëra të tjera të cilat mbesin në përgjegjësinë e tij që t'i shpalos nga përvoja, e gjitha kjo për të mbështetur arritjet e nxënësve të tij. Këto ueb-faqe duhet të respektojnë nevojat e prindërve që punojnë dhe nevojat e atyre me nivel të ulët arsimimi duke u ofruar mjete shtesë për të ndihmuar fëmijët e tyre me detyrat e shtëpisë.”

“Needs of the learning effect on instructional website for vocational high school nxënëss” është hulumtim i bërë nga (Lo, Fu, & Chuang, 2013) dhe i publikuar në “Turkish Online Journal of Educational Technology”. Autorët konkludojnë që “Ueb-faqet sigurojnë inkurajim të të mësuarit aktiv. Ato ofrojnë një ambient fleksibil si dhe mund të jenë një medie e dobishme për shkollën. Kjo e gjitha vetëm falë materialit të pasur dhe strukturës së plotë që e ndërthurin atë ueb-faqe. Mundësitë e sotme duhet të shfrytëzohen pasi që po jetojmë në një epokë ku interneti ka bërë ndryshime të mëdha në jetën e njerëzve dhe jo vetëm shkollat apo institucionet arsimore, të cilat me bashkëpunim të pandashëm me ekspertët e teknologjisë dhe me përpjekje pozitive mund të arrijnë të përmirësojnë efikasitetin e mësimin përmes sigurimit të një konteksti të përshtatshëm të përdorimit të internetit. Për më tepër autorët konkluduan që marrëdhënia midis vlerësimit të ueb-faqes dhe efikasitetit të mësimin ishte shumë pozitive. Të gjithë faktorët të cilët vlerësonin ueb-faqen në krahasim me efikasitetin e mësimin ishin dukshëm pozitiv. Dizajnimi i ueb-faqes, ndërveprimi dhe vendosja e konfigurimit të sistemit ishin të lidhura me të gjithë faktorët në efikasitetin e mësimin.”

Në artikullin “School websites: A physical education and physical activity content analysis” nga (McKenzie & D, 2019) i publikuar në “Journal of School Health” autorët konkludojnë se “Një ueb-faqe e mirë shkollore pritet të përfshijë një gamë të përmbajtjes cilësore. Shtylla e saj duhet të ketë informacione themelore si detajet e kontaktit, mesazhet përshëndetëse, vlerën e shkollës dhe imazhet në ueb-faqen kryesore të ndjekura nga burimet e të mësuarit, informacionet e kurrikulave, lajmet, kalendari i ngjarjeve dhe informacione të tjera shkollore.”

Studimi me titullin “Targeting Parent Trust to Enhance Engagement in a School-Home Communication System: A Double-Blind Experiment of a Parental Wise Feedback Intervention” i autoreve Alaa K. Hour, Andrew J. Thayer, and Clayton R. Cook (Hour,

Thayer, & Cook, 2019) konkludoi që “Kusht i rëndësishëm që mardhënia në mes prindërve dhe mësimitdhënësve të funksionojë duke rezultuar në suksesin e nxënësve në klasë është angazhimi i tyre për të ndërtuar këtë marrëdhënie. Ky mund të përkushtuar dhe i mirëmbajtur për t’u kujdesur tek forcimi i lidhjeve prindërore mund të rrisë angazhimin e atyre prindërve që në fund të fundit mund të përmirësojë sjelljet e nxënësve në shkollë dhe rezultatet në suksesin e tyre. Kjo ndërhyrje e bërë nga mësimitdhënësit kërkon burime të ulëta që mund të zbatohen lehtësisht gjatë gjithë vitit shkollor nga mësimitdhënësit tek prindërit dhe si rezultat jep marrëdhënie të forta prindërore dhe të sjelljes në shkollë. Nga të thënit në të bërë është një mal i tërë. Pra, ekziston ende hendeku për të hulumtuar se si është mënyra e duhur për të u zhvendosur prej dokumenteve të rëndësishme të angazhimit të marrëdhënieve prindër-shkollë e deri tek zhvillimi, aplikimi dhe testimi i këtyre metodave të shkruara në dokumente. Prindërit që kanë besim të plotë tek mësimitdhënësi i fëmijës së tyre, ka më shumë mundësi që të përfshihen në shkollë dhe programe të ndryshme të ofruara nga shkolla. Komunikimi i drejtpërdrejtë mësimitdhënës-prindër është demonstruar për të forcuar besimin e prindërve ndaj shkollës dhe mësimitdhënësve, duke rritur kështu angazhimin e tyre.”

Në artikullin e publikuar në “Frontiers Research Foundation” nga autorët (Kuusimäki, Uusitalo-Malmivaara, & Tirri, 2019) me titull “The Role of Digital School-Home Communication in Teacher Well-Being” i përpunuar nga anëtarë të universitetit të Helsinkit, të cilët u dakoruan se “Një partneritet i respektueshëm dhe i besueshëm midis prindërve dhe mësimitdhënësve në shkolla është thelbësor jo vetëm për nxënësit, por edhe për mirëqenien e të gjithë strukturës organizative të shkollës e cila ka përgjegjësinë e saj në lidhje me mardhënien me prindërit. Një partneritet i tillë koordinohet me komunikim të mirëfillt ndaj dy palëve. Në këtë hulumtim përmbledhet mendimi i shumë mësimitdhënësve, ku disa prej tyre e vlerësuan platformën digjitale si një mjet vlerësimi, për më tepër ata përfunduan që një platformë digjitale duhet të zhvillohet për të arkivuar vlerësimin në lidhje me punën me projekte, punën në grup dhe pjesëmarrjen e nxënësve në mësim. Një platformë digjitale e tillë mund të luajë rolin e një raportuesi i cili raporton vazhdueshëm informacione të dobishme tek prindërit në lidhje me përparimin e nxënësve në mësim. Në këtë hulumtim mësimitdhënësit pohojnë se parametri tjetër plotësues që kompletton funksionalitetin e një platforme digjitale ose një ueb-faqeje është lajmërimi i prindërve për shqetësimin e nxënësve që kanë gjatë orëve mësimore e që është pengesë në mësimin e tyre ose konfliktet e vazhdueshme të fëmijëve që kanë me fëmijët e tjerë. Përdorimi i komunikimit digjital është një ndër arsye kryesore për uljen e sjelljeve jo të mira

gjatë orëve mësimore, pasi që prindërit mund të shohin menjëherë reagimet e mësimdhënësve për sjelljen e nxënësve.”

Në studimin e kryer nga autorët (Álvarez & Inés-García, 2017) me titull “The management of schools’ websites in Cantabria, Spain” në disa shkolla të Spanjës, konkludohet që “Kryesisht studimi është një përgjithësim i procesit të krijimit ose zhvillimit të ueb-faqeve në shkolla. Si çdo fillim që është i vështirë për çfarëdo pune edhe fillimi i ndërtimit të një ueb-faqeje kërkon më shumë angazhim, nga mbledhja e të dhënave e deri tek strukturimi adekuat. Sa i përket pjesës teknike të krijimit të një ueb-faqeje në ditët e sotme është më lehtë, gjithashtu është më lehtë edhe mirëmbajtja e saj. Kjo nuk do të thotë që administratorët e ueb-faqeve nuk kanë nevojë të vazhdojnë të punojnë për të siguruar që ueb-faqet janë plotësisht të azhurnuara, por që situata aktuale, krahasuar me të kaluarën, është shumë pozitive. Kështu që administrata publike duhet të vazhdojë të gjeneroj sisteme për trajnimin dhe mbështetjen e shkollave. Autorët për më tepër konkludojnë se deklaratat që i kanë mbledhë tregojnë rezultat që menaxhimi i një ueb-faqeje në ditët e sotme është i lehtë dhe nuk kërkon trajnim specifik të sofistikuar, megjithëse kërkon kohë dhe përkushtim.” Studimi është i publikuar në revistën angleze “Research in Learning Technology”.

Krijimi i një ueb-faqeje merr në konsideratë shumë faktorë të cilët luajnë rol kyç në dizajnimin dhe funksionalitetin adekuat për audiencën e caktuar. Në revistën “Journal of Educational Technology & Society”, u publikua artikulli me titull “Youth as Design Partners: Age-Appropriate Websites for Middle and High School Nxënës” i autorëve (Chow, Smith, & Sun, 2012). Ky studim hulumtoi ndikimin e përdorimit të praktikave më të mira të identifikuar në studimet e mëparshme në hartimin e ueb-faqeve të përshtatshme për moshën për të rinjtë e shkollës fillore dhe atë të mesme. Autorët konkludojnë se “Elementet vizuale, funksionaliteti, ndërveprimi dhe lundrimi ndërtohen sipas parimeve të arkitekturës së informacionit. Këto janë principet kryesore më të rëndësishmet që duhet të merren parasysh gjatë dizajnit të një ueb-faqeje. Gjatë këtij studimi, projektuesit arritën të gjejnë analogjinë e qëllimeve organizative që nga fillimi i planifikimit të ndërtimit të ueb-faqes, por nuk arritën të përfshijnë preferencat e përdoruesit, kryesisht në hartimin grafik dhe elementët e kontrollit të përdoruesve të tilla si animacioni dhe ndërveprimi, cilësi të cilat angazhojnë përdoruesit e grupmoshës së re në ueb-faqen e caktuar ku ata kanë qenë të interesuar ta vizitojnë. Ky hulumtim shërben si udhërrëfyes për të tjerët të cilët duan të lehtësojnë punën e tyre gjatë krijimit të hapësirave më të përdorshme të internetit për adoleshentët. Kjo për shkak se procesi i dizajnit sistematik ka një rëndësi kritike për të nxitur sa më shumë përdorueshmërinë dhe për të ofruar rehatinë në ueb-faqe.

Mosrespektimi i një procesi të qëndrueshëm, i mbështetur nga hulumtimi dërgon në defekte gjatë projektimit të një ueb-faqeje.”

Edukimi gjithëpërfshirës dhe respektimi i diversitetit duhet të jenë të integruar në të gjithë shkollën, ky studim i titulluar “Middle Level Education Aims for Equity and Inclusion, but Do Our School Websites Meet ADA Compliance?” (Huss, 2019) hulumtoi mundësinë e përdorimit të ueb-faqeve të shkollave të mesme në Indiana, Kentucky dhe Ohio duke zgjedhur një mostër të rastit prej 150 shkollave. Nga 150 regjione, 54% kishin gabime që kërkojnë vëmendje të menjëhershme dhe të gjitha 150 shkollat kishin njoftime për shkelje të mundshme që shkonin nga lëshimet e tekstit dhe linqet boshe ose konfuze deri tek çështjet me kontraste ngjyrash brenda në ueb-faqe dhe navigimi vetëm me tastierë. Artikulli vazhdon të japë sugjerime praktike për eliminimin e shumë gabimeve, madje edhe për ato palë me ekspertizë më pak të sofistikuar teknologjike. Hulumtimi vijon “Gjashtë karakteristika që i përshkruajnë ueb-faqet shkollore janë: dizajni, inovacioni, përmbajta, teknologjia, ndërveprimi dhe lehtësimi në përdorim. Këto cilësi janë zbuluar nga shoqata e marketingut në internet e cila është një organizatë e përkushtuar për përsosmërinë e krijimit të ueb-faqes. Sipas tyre qasja në ndërtimin e një ueb-faqeje bëhet në tranzicion me diqka të gabuar, duke konkluduar që lehtësimi i përdorimit të një ueb-faqe si një ndër faktorët kryesor në dizajnimin po zëvendësohet më shumë me shumëllojshmërinë e tekstit dhe fotove të disponueshme. Ata më tej konkluduan se studimi nxjerrë në pah një perspektivë të re që tregon se studimi aktual duhet të ofroj një azhurnim të nevojshëm dhe të sjellë një perspektivë më të re në përputhje me arkitekturën e ueb-faqeve të shkollës së mesme. Në thelb statusi i ueb-faqeve të shkollave të mesme duhet të mbrohet me të gjitha ato mjete që janë në dispozicion për të ndihmuar atë. Konstruktuesit duhet të sigurohen që të dërgojnë mesazhe në përputhje me filozofinë dhe vizionin e përgjithshëm të shkollave të suksesshme për nxënësit e rinj.”

Artikulli i publikuar nga autorët (Stone & Springer, 2019) në “Australian Journal of Adult Learning” me titull “Interactivity, Connectedness and 'Teacher-Presence': Engaging and Retaining Nxënës Online” konkludojnë se, nuk mund të nënvlerësohet nga nxënësit rëndësia e një paraqitje e plotë e mësimdhënësve në internet, së bashku me hartimin e lëndëve që janë specifike dhe të përshtatshme për ofrim online. Përmes ndërthurjes së komunikimit të rregullt dhe të shpejtë ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësve, së bashku me hartimin e lëndëve interaktive, nxënësit në internet mund të angazhohen, mbështeten dhe inkurajohen në mënyrë më efektive për të vazhduar brenda mjedisit të mësimi online të cilin mund ta kenë në

dispozicion 24/7. E gjithë kjo punë e zellshme që bëhet nga mësimdhënësit duhet të mbështetet me një mbështetje të plotë duke përdorur strategji më të gjerë në të cilën patjetër që aplikohen vazhdimisht standardet e cilësisë për zhvillimin online. Çdo angazhim duhet të vlerësohet tek ata që mbështesin nxënësit në internet. Atyre duhet t'u jipet kohë, burime të mjaftueshme, trajnime të llojllojshme dhe më së shumti mbështetje të vazhdueshme që ata të ndihen mirë, se janë në rrugë të drejtë dhe nxënësit e tyre të marrin përvojë të qartë të angazhimit në internet. Pra me këtë sigurohet cilësia dhe qëndrueshmëria afatgjate e secilit institucion arsimor."

Një tjetër hulumtim "Curriculum Evaluation in Online Education: The Case of Teacher Candidates Preparing Online for Public Personnel Selection Examination" nga autori (Karacaoglu, 2018) në "International Journal of Higher Education" konkludoi që "Shumica e nxënësve e konsiderojnë mësimin në internet të këndshëm. Qasja në teknologji, aftësitë teknologjike të panumërta, motivimi dhe dobia e mjediseve të mësimit elektronik ndikojnë shumë pozitivisht në gatishmërinë e nxënësit. Nxënësit dhe mësimdhënësit vështroan që mësimi në internet ishte i dobishëm dhe erdhën në konkludim që kontribuoi në procesin e të mësuarit. Përmbajtja e teksteve elektronike paraqitet në një mënyrë të qartë dhe të saktë kjo u mundëson nxënësve të jenë në gjendje të ndjekin mësim nga kudo që janë dhe kjo mundësi është një shembull i qëlluar. Studimi i bërë ka cilësi të pacenueshme përkundër variablave si mosha, gjinia ose përvoja e mëparshme e mësimin në internet nga ana e nxënësve. Kjo sepse nuk u gjet ndonjë ndryshim statistikor në hulumtimet e mëhershme të bëra për po këtë arsye. Për më tepër konkludohen edhe disa disavantazhe tek angazhimi online "Disa nxënës mund ta kenë të vështirë të përqendrohen në mësim online nga shtëpia. Kjo, nga ana tjetër, çon në humbjen e motivimit. Disa nxënës deklaruan se disa mësimdhënës ndryshoheshin herë pas here dhe kjo hasi në vështirësi në përshtatjen e ligjëratave të reja, gjë që është një burim tjetër i pakënaqësisë dhe nivelit jo të qëndrueshëm arsimor. Ekzistojnë edhe probleme tjera që vijnë sigurisht me çfarëdo risie të caktuar siç janë ato teknike të cilat nuk kanë peshë aq të madhe në krahasim me rëndësinë e qëllimit të sistemit në tërësi. Tjetri disavantazh është mungesa e çiltërsisë së detajizuar në krahasim me orët mësimore ballë për ballë."

Hulumtimi i bërë nga autori (Tupas, 2015) me titull "Design and Development of LPU-B High School Website" arriti në përfundim që "Ueb-faqja shkollore duhet që përmbajtjen thelbësore t'a ketë informuese dhe të qartë. Qasja në ueb-faqe duhet të jetë e shpejtë si dhe menaxhimi i saj duhet të bëhet me lehtësi. Rekomandohet që çdo ueb-faqe të ketë një administrator personal dhe të azhurnohet rregullisht me lajmet dhe njoftimet më të fundit në lidhje me ngjarjet shkollore, kulturore dhe sportive. Ueb-faqja ka efikasitet nëse administratori i saj zgjedh

madhësinë e duhur të skedarëve të të dhënave online dhe fotografive të ndryshme që i vendos në të duke pasë parasysh që shumë shpesh ndodh të ketë modifikime dhe kështu mund të arrihet mbingarkimi i ueb-faqes gjë që nuk është e mirë pasi që një ueb-faqe e mirë shkollore duhet të jetë fleksibile dhe qëndrueshme. Mësimdhënësit mund t'i inkurajojnë nxënësit të përdorin portalin për qëllime edukative dhe diskutim të lirë për aktivitetet shkollore.”

(Jurkowski, 2018) në hulumtimin e tij me titull “School Library Website Components” arriti në përfundim që “Një ndër mënyrat më efikase për të ndërtuar ueb-faqen e një shkolle është vështrimi tek ueb-faqet që shkollat tjera i kanë dizajnuar pastaj duke vështiruar se cilat pjesë janë më të vlefshmet dhe duke i kopjuar posaqërisht ato pjesë. Më i mirë është hulumtimi i tri ueb-faqeve sesa i asnjë ueb-faqeje, por edhe më i mirë është hulumtimi i dhjetë ueb-faqeve sesa i tri ueb-faqeve. Arrijtja e rezultateve nuk është e lehtë por shpërblimi është i madh. Nga pikëpamja praktike, hapi i parë për krijimin ose rishikimin e një ueb-faqeje është arsyeja fillestare se pse në radhë të parë po krijohet ajo ueb-faqe. Atëherë mund të vendosim se ku dhe çfarë ndryshime do të nevojiten. Shumica e ueb-faqeve kalojnë nëpër periudha të ndryshme për të bërë rregullime themelore dhe organizim vetëm pasi që të kenë kaluar disa vjet. Një ndër problemet kryesore është që mendimi i riorganizimit duket i frikshëm gjë që bën administratorët e ueb-faqeve të ndihen sikur nuk kanë kohë për modifikime. Por nëse në fillim të planifikimit të krijimit të ueb-faqes janë ndërmarrë hapa të sigurtë dhe të saktë atëherë më vonë nuk do të duhet që të bëhen modifikime të mëdha dhe sigurisht koha do të kursehej. Organizata dhe institucione më të mëdha janë duke shkuar drejt krijimit të strukturës dhe hartimit të ueb-faqeve të tyre të krijuar nga kompani të jashtme që kanë aftësi për të krijuar modele mbresëlënëse. Kërkohet një vlerësim i dizajnit të ueb-faqeve, shkrim-leximi vizual, gjuha programuese (html) dhe duhet të mblidhen nga krijuesi i ueb-faqes. Aftësi më të ndërlikuara të programimit do të arrijnë një plus, por ndihma në ato fusha gjithmonë mund të gjendet nga diku tjetër. Ndërsa dizajni dhe pamja nuk mund të anashkalohen, udhëheqësit e shkollave tashmë janë të aftë për strukturën dhe organizimin dhe ata janë prej atyre që kanë njohuri se çfarë përmbajtjeje të përfshijnë në ueb-faqe.”

Gjatë hulumtimit të tyre autorët (Salvador & Rocha, 2014) erdhën në konkludim se “Ueb-faqet janë pasqyrim i institucioneve, por mirëmbajtja e përmbajtjes së tyre shpesh neglizhohet. Ueb-faqet e shkollave kanë disa veçori të mangësive si dokumentacioni, bashkëveprimi, siguria dhe mbështetja e vizitorit. Vizitorët për nga eksperiencia dhe dituria e tyre mund të influencojnë në vazhdueshmërinë e azhurnimit të ueb-faqes për tek vetitë e caktuara.”

Studimi i kryer nga autorët (Rotem & Oster-Levinz, 2007) me titull “The school website as a virtual learning environment” konkludojnë se “Qëllimi i ueb-faqes së shkollës është të sigurojë një përgjigje pedagogjike për nevojat e shkollës dhe të përbëjë një mjedis mësimor efikas dhe të organizuar në internet. Karakteristikat e të mësuarit në internet nga këndvështrimi organizativ propozojnë disa parime themelore sikurse: rikthimin e rëndësisë së shkollave për nxënësin dhe shoqërinë duke bërë ueb-faqen të arritshme për të gjithë; ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe sigurimin e një menaxhimi të qartë, plotësimi i nevojave të shkollës, mësimdhënës dhe nxënës; sigurimi i një zone automatike personale virtuale për çdo nxënës dhe përdorues të stafit drejtues dhe mësimdhënës; sigurimi i një zone virtuale për menaxhimin dhe stafin e mësimdhënësve dhe të nxënësve. Një ueb-faqe profesionale që rekomandohet të hartohet ka tri nivele: hapësirën në internet të lejuar për publikun e gjerë, hapësirën të kufizuara të lejuar për grupet e të mësuarit për të lehtësuar mësimin dhe fushat e punës personale për mësimdhënësit dhe nxënësit. Hartuesit e ueb-faqes kanë në dispozicion një kuti veglash virtuale të cilat mund të jenë të integruara në çdo fushë. Këto vegla janë: veglat që përfshijnë një bord buletini; një bord ngjarjesh; një orar; vegla që lehtësojnë ndërveprimin në internet; vegla të ndryshme mësimore në internet, siç janë gjeneruesit e provimeve dhe mjete për marrjen e informacionit nga interneti.”

“Në këtë botë të re të biznesit digjital, të kesh një ueb-faqe me cilësi të lartë dhe efektive është bërë një nga prioritetet kryesore strategjike për shumë shkolla. Megjithatë të gjithë investimet e mëdha që janë bërë në këtë fushë, nxënësët duket se nuk e kuptojnë plotësisht vlerën që ata e mendojnë nga ueb-faqet. Kjo nënvizon rëndësinë e të kuptuarit të faktorëve që ndikojnë në përdorimin e nxënësëve dhe pranimin e ueb-faqeve në kontekstin e arsimit të lartë. Cilësia e informacionit është faktori kryesor që ndikon në dobinë të kuptuarit, ndërsa cilësia e sistemit është faktori kryesor që ndikon në kuptimin e lehtë të përdorimit. Cilësia e sistemit nuk ka efekt të drejtpërdrejtë mbi kuptimin e dobisë, por kuptimi i lehtësisë së përdorimit dhe kënaqësia e kuptimit e ndërmjetësojnë këtë marrëdhënie.” është përfundimi që hulumtuesi (Al-Debei, 2014) përpiloi në artikullin me titull “The quality and acceptance of websites: an empirical investigation in the context of higher education”.

Tek studimi i autorëve (Prougestaporn, Visansakon, & Saowapakpongchai, 2015) konkludohet se “Më shumë se një dekadë më parë, interneti ka filluar të luajë një rol të madhë në botë si një mjet i përparimit teknologjik që ofron shumë përfitime për qenien njerëzore. Interneti gjithashtu është menduar të ndikonte në fushën arsimore sepse kjo ishte diçka që mediat kishin parashikuar paraprakisht për të krijuar mësim në distancë në formën e e-learning. Ndërkohë,

është menduar se mësimi elektronik mund të prodhonte mësim efektiv për mësimin e arsimit të lartë dhe të sigurojë më gjerë mundësi që nxënësit të regjistrohen në mësim online për të pasur qasje për të mësuar kudo dhe në çdo kohë pa u kërkuar që të ndjekin klasat. E gjithë kjo kohë e kaluar dhe sipas studimit gjatë krijimit të një ueb-faqeje duhet të mirren parasysh katër faktorë duke përfshirë diskutimin mbi pjesët kryesore të ueb-faqes: dizajnimi i skicës, zhvillimi si dhe shpërndarja në rrjetet sociale. Kështu vlerësimi i ueb-faqes mund të matet me këto kriterë që janë efektiviteti, kualiteti, shërbimi dhe shpejtësia.”

Hulumtimi i autorëve (Lim, Zhao, Tondeur, Chai, & Tsai, 2013) me titull “Bridging the Gap: Technology Trends and Use of Technology in Schools” konkludon që “Shumë investime janë bërë për të ofruar teknologjinë tek shkollat dhe këto investime kanë rezultuar me shumë histori suksesi. Sidoqoftë, ekzistojnë dy boshllëqe të rëndësishme të cilat duhet adresuar. Boshllëku i parë është që një nxënësi në ditët e sotme nuk ka kontroll se si të përdorë teknologjinë dhe sa kohë t’ia kushtojë. Boshllëku i dytë është përfundimi. Me këtë nënkuptojmë që përfundimi është çdo arritje në teknologji po përvetësohet gabimisht nga sektori i edukimit përkatësisht nga nxënësit të cilët nuk po drejtohen në mënyrën e duhur edhe pse me gjithë këto investime në teknologji në sektorët e edukimit produktiviteti nuk po rritet.”

Tek hulumtimi tjetër me titull “Usability Evaluation of University Websites” i autorëve (Galovicova, Kremenova, & Fabus, 2017) konkludohet që “Shkollat kanë një vend të veçantë në treg. Ato ofrojnë mundësi arsimore në fusha të veçanta. Tregu i institucioneve arsimore është i madh dhe jashtëzakonisht konkurrues. Megjithëse reputacioni dhe cilësia e institucioneve është një avantazh i madh, ata duhet të mendojnë për grupin e nënësve që kanë në synim, të cilët janë të rinjtë të cilët kalojnë disa orë në ditë në internet. Shkollat duhet të kenë ueb-faqet e tyre, të cilat i përfaqësojnë ato dhe kryejnë shumë funksione: shpërndarjen e informacioneve, komunikim me publikun e gjerë, publikime të ndryshme qoftë kulturore apo sociale. Ueb-faqet e shkollave janë të destinuara për mësimdhënësit, nxënësit e shkollave të mesme, partnerët e shkollës dhe administratën publike. Rezultati i studimit tregon që mendimet pyetësorëve qasin disa nga problemet bazike të ndërtimit të një ueb-faqeje. Probleme sikur se dizajnimi i ueb-faqes pa prirje dhe me një hije me grafikë të vjetër si nga vitet e 90-ta, dizajn i hutuar dhe i komplikuar, ueb-faqja kërkon që lexuesit të lexojnë lajmet e reja para se të qasen në linkun e dëshiruar, informacion i ngjeshur pa arsye, eksperience jo e mirë e përdoruesit në shikim të parë, fonti i vogël i shkronjave e shumë e shumë probleme tjera të vogla por që kanë vlerë tek secili vizitor ose nxënës.”

Nga studimi i kryer nga (Meyer & Wilson, 2011) me titull “The Role of Online Learning in the Emergency Plans of Flagship Institutions” është nxjerrë në përfundim se “Studimi është bërë gjatë kohës së pandemisë H1N1 në vitin 2009 ku institucionet arsimore e kanë adresuar këtë pandemi në ueb-faqen e tyre duke ofruar shumë njoftime dhe memorandume të drejtuara për nxënësët dhe prindërit e tyre, shkollën, stafin e saj si dhe komunitetin lokal. Të gjitha këshillat për nxënësët për të shmangur gripin dhe për të shmangur përhapjen e tij ishin shumë të qëndrueshme, duke përfshirë mënyrën e identifikimit të simptomave sikurse ethet, çfarë të bëjmë, duhet të pastrojmë duart dhe mënyra për të ndaluar përhapjen është qëndrimi në shtëpi. Edhe pse ueb-faqet kanë shërbyer shumë mirë duke dhënë udhëzime të qarta në atë kohë krize, asnjë institucion arsimor nuk kishte plane të gatishmërisë së katastrofës ose gatishmërisë emergjente që adresojnë vazhdimësinë akademike (ose si të trajtojmë klasat në raste urgjente). Nëse i adresojmë temat emergjente - të themi përmytjet, stuhitë, termentet apo pandemitë që kanë potencialin për të prishur vërtet misionin arsimor të institucionit atëherë shkollat duhet të kenë plane rezerve si dhe njoftime, udhëzime apo sygjerrime për të gjithë pjesëtarët e shkollës duke i njoftuar ata përmes ueb-faqes së shkollës se si duhet të vijojë mësimi online. Sipas studimit kjo nuk është parë në shumicën e shkollave në Amerikë. Ato pak institucione që kishin plane rezervë ndryshonin nga njëri tek tjetri si dhe përmendja e planit të vazhdimësinë akademike ishte jashtëzakonisht jo direkte, siç është theksimi i gjetjes së mënyrave alternative duke mos bërë të qartë hapat për t'u ndërmerrur.”

Hulumtimi i bërë nga (Baghdadi, 2011) konkludon se “Mësimi online paraqet sfida si për nxënësët ashtu edhe për mësimdhënësit. Mësimdhënësit duhet të jenë të përgatitur për të përmbushur kërkesat e veçanta të mësimdhënies në internet. Dizajnimi dhe zhvillimi i kurseve në internet gjë që shkolla ka përgjegjësi qoftë në ueb-faqen e saj apo në ndonjë ambient tjetër virtual ka nevojë për bashkëpunim të disa personave me një larmi interesash dhe ekspertizash, përfshirë administratorë, mësimdhënë, dizajnerë dhe specialistë teknikë. Secila lëndë brenda kurrikulës duhet të jetë e hartuar mirë dhe të përshtatet mirë brenda saj. Programi mësimor duhet të pasqyrojë gjendjen aktuale të disiplinës, duke i mundësuar nxënësve të zhvillojnë aftësi dhe zotësi të përshtatshme brenda lëndës specifike.”

Studimi i bërë nga (Bilgic & Tuzun, 2019) me titull “Issues and Challenges with Web-Based Distance Education Programs in Turkish Higher Education Institutes” konkludon që “Edukimi në distancë me të vërtetë ka krijuar një formë alternative të arsimit që eliminon kufijtë e kohës dhe hapësirës. Përdorimi i përhapur i kompjuterëve apo telefonave mobilë ka bërë që kufijtë e internetit të jenë gjithnjë e më shumë në të hapur duke ndihmuar arsimin në distancë të fitojë

një vrull të madh. Platformat e edukimit në distancë duke u bazuar në internet, referohen si teknologjitë më dominuese dhe të përparuara në fushën e arsimit në distancë. Natyrisht shkollat e arsimit të lartë janë faktorët më të rëndësishëm që duhet të ndjekin këto zhvillime. Prandaj është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm për çështjet thelbësore dhe sfidat e mundshme të këtij sistemi të ri ndërkohë që adaptojmë sistemin arsimor në zhvillimet e reja në fjalë. Çështjet thelbësore që lidhen gjatë krijimit të një programi arsimor në distancë duke u bazuar në internet janë procesi i fillimit të programit, legjislacioni, struktura e programit, hartimi i udhëzimeve, vlerësimi, komunikimi dhe ndërveprimi, mbështetja dhe çështjet teknike. Meqenëse arsimi në distancë i bazuar në internet është një mënyrë e re e mësimdhënies dhe mësimnxënies për shkollat, mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave duhet të fillojnë me një periudhë të mirë planifikimi që të kapin hapin e inovacionit dhe zhvillimit.”

Kapitulli III

3. PËRDORIM I UEB-FAQEVE SI PLATFORMË KOMUNIKIMI NË SHKOLLAT E ARSIMIT TË MESËM TË LARTË NË KOSOVË

Në këtë kapitull është bërë një analizë e përmbajtjes së ueb-faqeve në shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë dhe janë paraqitur rezultatet e nxjerra nga anketimet e realizuara me prindër dhe nxënës të AML. Për të pasur një pasqyrë më të qartë se në cilat shkolla ka komunikim më të mirë apo në cilat ka mungesë të komunikimit shtëpi shkollë përmes ueb-faqeve, rezultatet janë paraqitur ndaras për shkollat publike dhe ato private të AML.

3.1. Analizimi i përmbajtjes së ueb-faqeve në shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë

Sipas të dhënave të Divizionit për Arsim Privat Parauniversitar të publikuara në ueb-faqen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (Ministria e Arsimit, 2018) në Republikën e Kosovës janë gjithsej 25 shkolla të rregullta private të AML (niveli III) duke i përfshirë shkollat artistike, institucionet arsimore aftësuese si dhe qendrat aftësuese profesionale. Nga këto shkolla ne e kemi realizuar një hulumtim në lidhje me përmbajtjen e ueb-faqeve të tyre. Në mostrën e këtij hulumtimi janë përfshirë 14 shkolla që përbëjnë 56% të totalit të shkollave të rregullta private të AML. Ueb-faqet e shkollave publike të AML nuk kanë qenë subjekt i hulumtimit për faktin se nga anketimet e bëra me prindër dhe nxënës të shkollave të AML si dhe nga kërkimet e bëra në ueb-faqen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka rezultuar se këto shkolla nuk kanë ueb-faqe zyrtare.

Për ta bërë një vlerësim të përmbajtjes së ueb-faqeve të shkollave që kanë qenë subjekt i hulumtimit i kemi përdorur disa kritere vlerësuese të paraqitura në tabelën e më poshtme:

Nr	Kriteret për vlerësimin e ueb-faqeve të shkollave të AML
1	Përmbajta e ueb-faqes e lehtë për tu naviguar
2	Informata rreth historikut të shkollës
3	Lajme dhe njoftime
4	Kalendari i aktiviteteve
5	Materiale mësimore për lexim
6	Njoftime rreth aktiviteteve mësimore në shkollë
7	Njoftime rreth aktiviteteve organizative të shkollës (vizita, shëtitje etj.)
8	Përditësim i rregullt i informatave
9	Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për mësimeve
10	Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për nxënësit
11	Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për prindërit
12	Mësim elektronik (e-learning)
13	Kontaktet e personelit të shkollës

Tabela 2. Kriteret për vlerësimin e ueb-faqeve të shkollave të AML

Kriteret e vlerësimit që janë të përmendura në tabelën e mësipërme janë përdorur si kritere bazë që ne e kemi vlerësuar se janë të nevojshme për një ueb-faqe të shkollës. Çdo ueb-faqe është vlerësuar duke përdorur këtë listë të kritereve të vlerësimit si një listë kontrolluese. Vlerësimi është bërë në bazë të faktit se a ka ueb-faqja elemente të secilës pikë të vlerësimit duke e shënuar me “PO” ose “JO”.

Për vlerësimin e ueb-faqeve në përgjithësi ka mjaft materiale të publikuara në internet por vlerësimi i ueb-faqeve të shkollave është më i veçantë andaj jemi munduar që të ja përshtasim edhe kriteret lartë përmendura.

Kur e përmendim fjalën kriter, ne i referohemi standardeve që na ndihmojnë për të vlerësuar sa sa kanë vlerë ueb-faqet e shkollave dhe t'i dallojmë ato që janë informuese, të sakta dhe të dizajnuara mirë nga ato jo informuese, të pasakta dhe ato jo të dizajnuara mirë.

Në figurën e mëposhtme janë prezantuar rezultatet e nxjerra nga vlerësimi i ueb-faqeve të shkollave sipas kritereve që i kemi përcaktuar ku për secilën prej pikave të vlerësimit rezultatet do të shqyrtohen veç e veç.




Figura 1. Rezultatet e vlerësimit të ueb-faqeve të shkollave të AML

Gjatë vlerësimit të ueb-faqeve të shkollave një nga elementet e epara që e kemi analizuar ka qenë fakti se sa janë të lehta për t'u naviguar. Kemi konkluduar që të gjitha ueb faqet që kanë qenë subjekt i hulumtimit janë lehtë të navigueshme.

Kemi vlerësuar se paraqitja e informatave rreth historikut të shkollës ka rëndësi për përdoruesit e ueb-faqeve të shkollave që të njihen më për së afërmi me shkollën dhe ti kuptojnë vlerat e sajë, 93% e shkollave që kanë qenë subjekt i hulumtimit kanë informata rreth historikut të shkollës.

Shumica e ueb-faqeve të shkollave të hulumtuara (93% prej tyre) posedojnë lajme dhe njoftime dhe 86% prej shkollave posedojnë kalendarin e aktiviteteve.

Vërehet një mungesë e konsiderueshme e materialeve mësimore për lexim ku vetëm 36% e ueb-faqeve të përfshira në hulumtim kanë materiale mësimore të publikuara ndërsa 64% nuk kanë materiale mësimore të publikuara që do të mund të përdorëshin për lexim nga nxënësit.

Sa i përket njoftimeve rreth aktiviteteve mësimore të shkollës vërehet se 71% e ueb-faqeve të shkollave që janë hulumtuar kanë të publikuara njoftime rreth aktiviteteve mësimore të shkollës dhe vetëm 29% prej tyre kanë mungesë të publikimeve të tilla.

Rreth 57% e ueb-faqeve të shkollave të përfshira në hulumtim kanë të publikuara njoftime rreth aktiviteteve organizative të shkollës dhe 43% nuk kanë të publikuara aktivitete të tilla.

Një komponentë tjetër me rëndësi është edhe që informatat të jenë të përditësuara që të paraqesin gjendjen faktike të kohës. Në këtë aspekt nga hulumtimi është vërejtur se 64% e ueb-faqeve të shkollave të hulumtuara i kanë informatat e përditësuara dhe 36% prej tyre nuk i kanë përditësuar informatat me kohë.

Nga aspekti i sigurisë dhe konfidencialitetit të informatave ku përdoruesve të ueb-faqeve do t'u mundësohej qasja me përdorues dhe fjalëkalim kemi vërejtur se kjo komponentë ka mangësi. Vetëm 29% e ueb-faqeve ofrojnë qasje si për mësimdhënës ashtu edhe për prindër ndërsa 21% e tyre edhe për nxënës.

Një formë bashkëkohore e të mësuarit, ajo e mësimit elektronik (ang. e-learning) nuk është edhe aq e zhvilluar në shkollat private të AML. Vetëm 36% e ueb-faqeve të këtyre shkollave ofrojnë mësim elektronik ndërsa 64% e tyre nuk e ofrojnë këtë mundësi.

Për të pasur një komunikim më të lehtë dhe qasje më të shpejtë me personelin e shkollës është analizuar se a kanë ueb-faqet e shkollave të publikuara kontaktet e personelit të shkollës ku ka rezultuar se 36% prej tyre i kanë të publikuara kontaktet e personelit të shkollës ku përfshihet personeli menaxhues dhe mësimdhënësit ndërsa 64% nuk i kanë të publikuara informatat e tilla.

Bazuar në hulumtimin e lartëpërmendur ku janë vlerësuar përmbajtjet e ueb-faqeve të shkollave të AML në Republikën e Kosovës fillimisht do të kishim sugjeruar që për shkollat publike të AML që nuk kanë fare ueb-faqe të shkollës të marrin iniciativa për krijimin e tyre. Për krijimin e këtyre ueb-faqeve do të mund të përdorëshin kriteret minimale që i kemi përmendur në këtë hulumtim si pikënisje me mundësi të zhvillimit të mtjeshëm varësisht nga nevojat e kohës. Po ashtu për shkollat private të AML do të kishim sugjeruar që ta zhvillojnë më shumë komponenten e qasjes me përdorues dhe fjalëkalim si nga ana e mësimdhënësve, prindërve ashtu edhe nga ana e nxënësve. Sugjerimi tjetër është që të ofrohen më shumë materiale

elektronike duke përfshirë mësimin elektronik që do t'i ofronin nxënësve mundësi më të lehta për lexim nga pajisje të ndryshme kompjuterike dhe teknologjisë mobile.

3.2. Analiza e anketimit me prindër

Është paraqitur mënyra grafike e anketimeve të realizuara me prind ku paraqitet përdorimi i ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve




Figura 2. Në çfarë shkolle vijon mësimin fëmiu i juaj?

Bazuar në grafikën 1, në këtë pyetësore morën pjesë 80 prind, ku 83% ishin prindër që i kanë fëmijët në shkollë publike dhe 17% në shkollë private.




Figura 3. Në cilën klasë vijon mësimin fëmiu i juaj?

Në grafikun numër 2 vërehet se një numër më i madh i të anketuarve që përbëjnë 62% e totalit të të anketuarve kanë deklaruar se fëmijët e tyre janë në klasën e dhjetë ndërsa nga 19% në klasën e njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë.




Figura 4. A ka shkolla e fëmiut tuaj ueb-faqe zyrtare?

Në këtë grafik është paraqitur përqindja e të anketuarve në pyetjen se a ka shkolla e fëmiut tuaj ueb-faqe zyrtare, ku 75% prej të anketuarve kanë deklaruar që nuk ka, kurse 25% janë deklaruar që ka ueb-faqe zyrtare.




Figura 5. A ka shkolla e fëmiut tuaj ueb-faqe zyrtare?

Në pyetjen se a ka shkolla e fëmiut tuaj ueb-faqe zyrtare 61 prind të shkollave publike janë deklaruar që shkollat e fëmijëve të tyre nuk kanë ueb-faqe zyrtare dhe nuk ka një komunikim

të tillë përmes kësaj platforme, ndërsa 19 prind të shkollave private kanë deklaruar që shkollat e fëmijëve të tyre kanë ueb-faqe zyrtare dhe se kjo platformë i mundëson një komunikim të tillë.




Figura 6. Sa shpeshë e vizitoni ueb-faqen e shkollës së fëmiut tuaj?

Pas pyetjes së parashtruar në grafikonet e mëhershme dhe deklarimeve nga ana e prindërve që fëmijët e tyre kanë ueb-faqe zyrtare në shkollat private atëherë bazuar në grafikën e 5, vërejmë se pjesa më e madhe e prindërve të shkollave private ueb-faqen e fëmiut të tyre e vizitojnë një ose dy herë në javë ose 47.37%, çdo ditë 26.32%, asnjëherë 5.26% dhe një deri në tre herë në muaj 21.05%.

	Gjithmonë	Shpesh	Rrallë	Asnjëherë
Postë elektronike (e-mail)	47%	37%	11%	5%
Dërgesave me postë	5%	5%	79%	11%
Letra të dërguara nga mësimmshënësi përmes fëmiut	37%	32%	16%	16%
Mediat sociale (facebook, instagram, twitter etj)	32%	16%	53%	0%
Thirrjeve telefonike nga shkolla	11%	32%	58%	0%
Ueb-faqja e shkollës	47%	11%	42%	0%

Tabela 3. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme për fëmiun tuaj nga shkolla?

Nga tabela e mësipërme mund të dallojmë se në çfarë forme i pranojnë informacionet e përgjithshme për fëmiun e tyre prindërit e fëmijëve të shkollave të mesme private. Vërehet se komunikimi më i rrallë është përmes dërgesave postare ndërsa komunikimi më i shpeshtë është përmes postës elektronike. Në këtë analizë vërejmë se edhe komunikimi përmes ueb-faqes së shkollës tregon një përqindje mjaft të lartë të përdorimit ku 58% e të anketuarve e përdorin gjithmonë ose shpesh ueb-faqen si platformë komunikimi dhe 42% e përdorin më rrallë.




Figura 7. Cilat nga elementet e mëposhtme i përmban ueb-faqja e shkollës së fëmijut tuaj?

Nga grafiku numër 6, vërejmë se cilat nga elementet i përmban ueb-faqja e shkollës së fëmijëve që vijnë në mesimin në shkollë private ku sipas përgjigjeve të dhëna nga ana e prindërve mund të themi se shumica e shkollave private i plotësojnë kriteret. Se a ka informata rreth historikut të shkollës 95% kanë thënë Po, kurse 5% kanë thënë Jo. A ofrohen lajme dhe njoftime 89% kanë thënë po, kurse 11% kanë thënë Jo. Në ueb-faqen e shkollës së fëmijut tuaj se a ka kalendari të aktiviteteve tuaja 89% kanë thënë Po, kurse 11% kanë thënë Jo. Gjithashtu se a keni qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për nxënësit 58% kanë thënë Po, kurse 42% kanë thënë Jo. Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për prindërit 42% kanë thënë Po, kurse 58% kanë thënë Jo. Se a i ofrohet nxënësve mësim elektronik (e-learning) 47% kanë thënë po, kurse 53% kanë thënë jo. Se a ofrohen kontaktet e personelit të shkollës në ueb faqet e tyre 95% janë deklaruar Po, kurse 5% Jo. Nga këto ueb-faqe a i mundësohet prindërve të kenë qasje në suksesin e fëmijëve të tyre 58% janë deklaruar që i ofrohet kjo mundësi nga ueb-faqet e shkollave, kurse 42% kanë thënë Jo.




Figura 8. Ndikimi i komunikimit përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës

Nga grafiku mund të vërehet se komunikimi përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës sipas të anketuarëve ka ndikuar 100% pozitivisht në motivimin e nxënësve, përmirësimin e komunikimit prind-mësimdhënës dhe informimin rreth aktiviteteve të shkollës, kurse 95% në rritjen e sigurisë në shkollë dhe në suksesin dhe shkallën e mësimdhënies, 5% asnjëra dhe 0% negativisht.




Figura 9. Si ka ndikuar komunikimi me shkollën përmes ueb-faqes zyrtare në aspektin e menaxhimit të kohës?

Bazuar në grafikun e mësipërm, dallohet qartë se komunikimi përmes ueb-faqeve zyrtare i kursen shumë kohë prindërve për të komunikuar me shkollën e fëmijëve të tyre. 100% prej tyre janë deklaruar se i kursen kohë një komunikim i tillë.




Figura 10. Në përgjithësi si e vlerësoni ueb-faqen e shkollës së fëmijut tuaj?

Sipas grafikut të mësipërm, vërejmë vlerësimin në përgjithësi për ueb-faqen e shkollës së fëmijut tuaj ku 53% e të anketuarëve janë deklaruar se informatat janë shumë mirë në dispozicion, 37% kanë thënë se janë mirë dhe 11% nevojitet përmirësim. Sa i përket gjetjes së lehtë të informatave 79% janë deklaruar shumë mirë kurse 21% mire. Po ashtu se çfarë përshtypje kanë për ueb-faqet e shkollave të fëmijëve të tyre 42% janë deklaruar shumë mirë, 47% mirë dhe 11% nevojitet përmirësim.




Figura 11. A mendoni se është e nevojme që shkolla e fëmijut tuaj të ketë një ueb-faqe zyrtare?

Sipas grafikut 11, vërejmë se 100% e prindërve që i kanë fëmijët në shkollat publike mendojnë se është e nevojme që shkolla e fëmijut tuaj të ketë një ueb-faqe zyrtare.

	Gjithmonë	Shpesh	Rrallë	Asnjëherë
Postë elektronike (e-mail)	0%	18%	15%	67%
Dërgesave me postë	0%	18%	13%	69%
Letra të dërguara nga mësime dhënësi përmes fëmijut	51%	3%	20%	26%
Mediat sociale (facebook, instagram, twitter etj)	3%	18%	25%	54%
Thirrjeve telefonike nga shkolla	10%	25%	64%	2%
Ueb-faqja e shkollës	0%	18%	13%	69%

Tabela 4. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme për fëmijun tuaj nga shkolla?

Bazuar në tabelën e mësipërme, mund të vërejmë se në çfarë forme i pranojnë prindërit e fëmijëve të shkollave të mesme publike informacionet e përgjithshme për fëmijët e tyre. Në shkollat publike të AML ka më pak komunikim të formës digjitale. Pra më shumë pranojnë letra të dërguara nga mësime dhënësit përmes fëmijëve të tyre dhe më rrallë përmes thirrjeve telefonike.




Figura 12. Cilat nga elementet e mëposhtme duhet t'i përmbajë ueb-faqja e shkollës së fëmijut tuaj?

Sipas figurës 12 dhe pyetjes se cilat nga elementet e mëposhtme duhet t'i përmbajë ueb-faqja e shkollës së fëmijut tuaj, prindërit e fëmijëve të shkollave publike në përqindje të lartë janë deklaruar si: informata rreth historikut të shkollës, lajme dhe njoftime, kalendarin e aktiviteteve, qasje me përdorues dhe fjalëkalim për nxënësit, qasje me përdorues dhe fjalëkalim për prindërit, mësim elektronik, kontaktet e personelit të shkollës si dhe qasje në suksesin e nxënësve.




Figura 13. Në rast se shkolla e fëmijut tuaj do të krijojë një ueb-faqe zyrtare, si do ta vlerësonit ndikimin e sajë?

Sipas grafikut 13, dhe pyetjes se në rast se shkolla e fëmijut tuaj do të krijojë një ueb-faqe zyrtare, si do ta vlerësonit ndikimin e sajë, prindërit e shkollave publike janë deklaruar se 85% do të ndikoj pozitivisht në motivimin e nxënësit, 13% janë deklaruar se nuk do të ketë efekt, dhe 2% kanë thënë se do të ndikoj negativisht në motivimin e nxënësit. Sa i përket komunikimit prind-mësimdhënës dhe informimit rreth aktiviteteve të shkollës të anketuarit janë deklaruar se 100% do të ndikoj pozitivisht. Gjithashtu të anketuarit janë deklaruar se komunikimi përmes ueb-faqes 85% do të ndikoj pozitivisht në rritjen e sigurisë në shkollë, 2% janë deklaruar se do të ndikoj negativisht dhe 11% nuk do të ketë ndikim në rritjen e sigurisë në shkollë. Se a do të ketë ndikim komunikimi përmes ueb-faqes në rritjen e suksesit dhe shkallën e mesimnxënies 95% e të anketuarëve janë deklaruar se do të ndikoj pozitivisht, 2% janë deklaruar se do të ketë ndikim negativ dhe 3% janë deklaruar se nuk ka do të ketë ndikim një komunikim i tillë në rritjen e suksesit dhe shkallën e mësimdhënies.




Figura 14. A mendoni se komunikimi online me shkollën do të kishte efekt pozitiv në menaxhimin e kohës?

Bazuar ne grafikën 14, dhe pyetjes se a mendoni se komunikimi online me shkollën do të kishte efekt pozitiv në menaxhimin e kohës 100% e prindërve të anketuar janë përgjigjur se do ta kursente shumë kohën një komunikim i tillë i ofruar nga ana e shkollës.




Figura 15. Në përgjithësi si do ta vlerësoni ueb-faqen e shkollës së fëmiut tuaj?

Sipas grafikës 15, dallojmë se si do ta vlerësonin prindërit komunikimin përmes një ueb- faqe dhe se interesimi është shumë i madh i të anketuarëve që t'u ofrohet nje komunikim i tillë përmes ueb-faqeve zyrtare për arsimin e mesëm të lartë në Kosovë.

3.3. Komunikimi përmes ueb-faqeve në shkollat publike të Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë

Bazuar në anketimet e bëra me 394 nxënës të shkollave publike të AML në Kosovë rezulton që shkollat publike të AML në Kosovë nuk kanë pothuajse fare platformë komunikimi shtëpi-shkollë përmes ueb-faqeve zyrtare. Po ashtu në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 nuk është paraparë që të zhvillohet ndonjë projekt për zhvillimin e ueb-faqeve të shkollave.




Figura 16. Pjesëmarrja e respondentëve në shkollat publike sipas klasëve

Nga 394 nxënës të anketuar të shkollave publike të AML, ka pasur një pjesëmarrje më të madhe nga nxënësit e klasës së 11-të që përbëjnë 59% të numrit të përgjithshëm të të anketuarve, 27% janë nxënës pjesmarrës të klasave të 10-ta dhe 14% janë nxënës pjesmarrës të klasave të 12-ta. Në Tabelën e më poshtme janë paraqitur përgjigjet për të gjitha mënyrat e komunikimit ndërmjet nxënësve dhe shkollës.

	Gjithmonë	Shpesh	Rrallë	Asnjëherë
Postë elektronike (e-mail)	☐ 5%	☐ 13%	☐ 36%	☒ 46%
Dërgesave me postë	☐ 1%	☐ 1%	☐ 9%	☒ 90%
Letra të dërguara nga mësimdhënësi përmes nxënësit	☐ 5%	☐ 11%	☐ 22%	☒ 62%
Mediat sociale (facebook, instagram, twitter etj)	☐ 24%	☒ 41%	☐ 24%	☐ 11%
Thirrjeve telefonike nga shkolla	☐ 3%	☐ 16%	☐ 25%	☒ 56%
Ueb-faqja e shkollës	☐ 6%	☐ 11%	☐ 28%	☒ 54%

Tabela 5. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme nga shkolla?

Në pyetjen e bërë “Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme nga shkolla” vërehet se komunikimi shtëpi-shkollë më së shumti realizohet përmes mediave sociale. Shumica e të anketuarve janë deklaruar se asnjëherë nuk i pranojnë informacionet e përgjithshme nga shkolla përmes ueb-faqeve të shkollës.





Figura 17. A mendoni se është e nevojme që shkolla e juaj të ketë një ueb-faqe zyrtare?

Shumica e nxënësve të anketuar (92% e tyre) kanë deklaruar se është e nevojshme që shkolla e tyre të ketë ueb-faqe zyrtare. Kjo e dëshmon nevojën e kohës dhe dëshirën e nxënësve për të pasur një mundësi më të lehtë të komunikimit shtëpi-shkollë.



Gjithashtu një numër i konsiderueshëm i nxënësve (66%) e kanë konfirmuar se do ta kishin përdorur komunikimin përmes ueb-faqes për t'u konsultuar me mësimdhënësit, ndërkaj 29% e tyre nuk kanë qenë të sigurt se do të kishin pasur mundësi ta bëjnë një gjë të tillë dhe 5% prej nxënësve të anketuar janë deklaruar se nuk do ta shfrytëzonin ueb-faqen e shkollës për t'u konsultuar me mësimdhënësit rreth çështjeve mësimore.

Figura 18. A do ta kishit shfrytëzuar ueb-faqen e shkollës për t'u konsultuar me mësimdhënësit rreth çështjeve mësimore?




Figura 19. Çka mendoni, cilat nga elementet e mëposhtme duhet t'i përmbajë ueb-faqja e shkollës tuaj?

Sa i përket elementeve që duhet të i përmbajë një ueb-faqe e shkollës, vërejmë se përveq në elementet ku përmendet qasja me përdorues dhe fjalëkalim ka një tendencë që të mos ketë qasje por në elementet tjera shumica e nxënësve të anketuar pajtohen që ueb-faqja duhet të i përmbajë të gjitha ato elemente që janë të paraqitura në grafiken e dhënëato. Pra, me fjalë të tjera nga nxënësit e anketuar kërkohet më shumë që ueb-faqja të përdoret për lajme, njoftime si dhe për mësim elektronik.




Figura 20. Ne rast se shkolla juaj do të krijojë një ueb-faqe zyrtare, si do ta vlerësonit ndikimin e sajë në

Lidhur me ndikimin e ueb-faqeve zyrtare në aspektin e ngritjes së cilësisë në mësim-nxënje, sigurinë në shkollë, informim dhe komunikim më të mirë shtëpi-shkollë si dhe përmirësimin e komunikimit me mësimdhënësit ka një përqindje të lartë të anketuarëve që mendojnë se ka ndikim pozitiv.




Figura 21. A mendoni se komunikimi online me shkollën do të kishte efekt pozitiv në menaxhimin e kohës?

Përveq ndikimit pozitiv në mësim-nxënje si dhe aspekte tjera të ngritjes së cilësisë në komunikim, shumica e nxënësve (77%) e kanë konfirmuar se komunikimi përmes ueb-faqeve të shkollës ka efekt pozitiv në menaxhimin cilësorë të kohës.






Figura 22. Komunikimi përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës a do t'iu kishte stimuluar që të keni arritje më të lartë në mësim-nxënie?

Gjithashtu përveq konfirmimit që komunikimi shtëpi-shkollë përmes ueb-faqeve zyrtare ndikon pozitivisht në menaxhimin e kohës, një aspekt tjetër që konsiderohet mjaft me rëndësi është edhe ndikimi i këtij komunikimi edhe në ngritjen e cilësisë në mësim-nxënje ku shumica e nxënësve (80%) janë deklaruar se ka një efekt pozitiv.



Një aspekt tjetër me rëndësi është edhe atraktiviteti i shkollave dhe ndikimi i tyre në motivimin e nxënësve. Në këtë kontekst një numër i madh i nxënësve të anketuar kanë mendim pozitiv për faktin se komunikimi i tyre me shkollën përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës do të ndikonte në ngritjen e motivimit të tyre.

Figura 23. Si do ta vlerësonit ndikimin e ueb-faqes zyrtare të shkollës në motivimin tuaj?



Përveq konfirmimit që komunikimi shtëpi-shkollë përmes ueb-faqeve zyrtare ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve, ata e kanë konfirmuar se do të kishte efekt pozitiv edhe në arritje më të lartë në mësim ku shumica e nxënësve (74%) janë deklaruar se ka një efekt pozitiv.

Figura 24. Si do ta vlerësonit ndikimin e komunikimit mësimdhënës-prind-nxënës përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës në suksesin tuaj në mësim?





Figura 25. Si do ta vlerësonit në përgjithësi komunikimin me shkollën përmes ueb-faqes?

Vlerësimi i përgjithshëm i nxënësve në lidhje me rëndësinë e komunikimit me shkollën përmes ueb-faqes zyrtare ka qenë mjaft pozitiv ku nga shkalla e vlerësimit prej një deri në dhjetë rreth 86% e të anketuarve e kanë dhënë vlerësimin me shkallë më të lartë se pesë (6-10), ndërsa pjesa tjetër me shkallë më të ulët të vlerësimit.

3.4. Komunikimi përmes ueb-faqeve në shkollat private të Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë

Nga rezultatet e anketimit me nxënës të shkollave private të AML (156 të anketuar) si dhe nga hulumtimi i bërë në internet shihet se shkollat private të AML kanë ueb-faqe zyrtare të shkollës.



Nga Figura 11 vërehet se shpeshtësia e vizitimit të ueb faqeve të shkollave private të AML është relativisht e lartë ku 8% e të anketuarve janë deklaruar se e vizitojnë ueb faqen e shkollës çdo ditë ndërsa 69% e të anketuarve e vizitojnë ueb faqen disa herë mbrenda muajit ndërsa vetëm 23% e tyre janë deklaruar se nuk e vizitojnë ueb faqen.

Figura 26. Sa shpesh e vizitoni ueb-faqen e shkollës?




Figura 27. Informatat që merren më së shpeshti nga ueb faqet e shkollave private të AML

Informacionet që shkollat private të AML i paraqesin në ueb faqet e tyre duket të jenë të pasuruara me njoftime rreth aktiviteteve të shkollës dhe gjithashtu përmbajnë edhe informata rreth suksesit të nxënësve dhe materiale mësimore.




Figura 28. Qka mendoni se i mungon ueb-faqes së shkollës suaj

Megjithatë janë vërejtur edhe disa mangësi ku prej tyre më të shprehura janë publikimi i materialeve mësimore në formë elektronike si dhe ka mungesë të qasjes me fjalëkalim si për mësimeve ashtu edhe për prindër dhe nxënës. Kjo do të mundësonte që disa prej informatave që konsiderohen konfidenciale të jenë të qasshme vetëm nga përdoruesi i caktuar dhe do të ishin të mbrojtura në aspektin e sigurisë ku vetëm përdoruesit e autorizuar do të kishin mundësinë e marrjes së informacioneve nga ueb faqja e shkollës.

	Gjithmonë	Shpesh	Rrallë	Asnjëherë
Postë elektronike (e-mail)	 37%	 50%	 5%	 8%
Dërgesave me postë	 0%	 4%	 20%	 76%
Letra të dërguara nga mësimeve përmes nxënësit	 19%	 22%	 31%	 27%
Mediat sociale (facebook, instagram, twitter etj)	 3%	 60%	 24%	 13%

Tabela 6. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme nga shkolla?

Sa i përket mënyrës së komunikimit vërehet se kanali kryesorë i komunikimit shtëpi-shkollë është përmes postës elektronike dhe mediave sociale ndërsa rrallë përmes letrave të dërguara nga mësimeve përmes nxënësit tek prindërit e tyre. Dërgesat me postë pothuajse nuk përdoren fare. Në këtë kontekst mund të thuhet se komunikimi përmes mediave elektronike e ka zëvendësuar pothuajse plotësisht komunikimin tradicional përmes dërgesave postare apo dokumenteve fizike.




Figura 29. Cilat nga elementet e mëposhtme i përmbanë ueb-faqja e shkollës suaj?

Sipas përgjigjeve të marra nga të anketuarit, mund të dallojmë se një përqindje e madhe e ueb-faqeve të shkollave i kanë në ueb faqet e tyre disa nga elementet që i kemi pyetur nxënësit si: informata rreth historikut të shkollës, lajme dhe njoftime si dhe kontaktet e personelit, kurse elementet e tjera si: qasje me përdorues dhe fjalëkalim për nxënësit, qasje me fjalëkalim për mësime dhënësit, qasje me fjalëkalim për prindërit, mësimi elektronik si dhe qasje nga prindërit dhe nxënësit në suksesin dhe vijueshmërinë të anketuarit janë deklaruar se nuk i posedojnë në ueb-faqet e tyre të shkollave, kurse një përqindje vogël i posedojnë edhe këto elemente.




Figura 30. A e shfrytëzoni ueb-faqen e shkollës për t'u konsultuar me mësime mësimdhënësit rreth qështjeve mësimore?

Në kuadër të komunikimit nxënës-mësime, një komponentë me rëndësi është edhe konsultimi për qështje mësimore. Duket se një numër i konsiderueshëm i nxënësve të anketuar (37%) e përdorin këtë kanal të komunikimit për këtë qështje.




Figura 31. Komunikimi përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës ka ndikuar në:

Sipas përgjigjeve të marra nga të anketuarit vërehet se komunikimi përmes ueb-faqes zyrtare ka ndikuar më shumë pozitivisht sesa negativisht në rritjen e sigurisë në shkollë, informim dhe përmirësim të komunikimit si dhe në motivimin e nxënësve, megjithëse një numër i vogël i të anketuarve kanë deklaruar se ka një dozë të vogël të ndikimit negativ si dhe një masë e konsiderueshme e të anketuarve nuk kanë qenë të gatshëm ta vlerësojnë këtë ndikim.




Figura 32. Sa mendoni se ueb-faqja i plotëson nevojat e kohës?

Nga figura e më poshtme vërehet se ueb-faqet e shkollave private të AML i plotësojnë relativisht nevojat e kohës mirëpo ka ende hapësirë për përmirësim.




Figura 33. Në përgjithësi si e vlerësoni ueb-faqen e shkollës suaj?

Në përgjithësi ueb-faqet e shkollave private të AML janë vlerësuar pozitivisht nga të anketuarit, mirëpo një masë e konsiderueshme janë deklaruar se ueb-faqet kanë nevojë për përmirësim.

Kapitulli IV

4. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

4.1. Konkluzionet

Duke u bazuar në hulumtimet e bëra përmes anketimeve me prindër dhe nxënës të shkollave të AML në Republikën e Kosovës si dhe nga hulumtimet e bëra në internet duke i analizuar ueb-faqet e shkollave dhe përmbajtjet e tyre vërehet se shkollat private të AML në Kosovë janë më të avancuara në komunikimin shtëpi-shkollë përmes ueb-faqeve zyrtare të shkollës krahasuar me shkollat publike të arsimit të mesëm të lartë.

Nga anketimi i realizuar me prindërit e nxënësve të shkollave të AML rezulton që 100% e të anketuarve që fëmijët e tyre vijnë në mësimin në shkolla private të AML kanë ueb-faqe zyrtare të shkollës. Po ashtu të gjithë të anketuarit që fëmijët e tyre vijnë në mësimin në shkolla publike të AML kanë deklaruar se shkolla nuk ka ueb-faqe zyrtare.

Nga rezultatet e anketimit me nxënës të shkollave të AML ku nga gjithsej 550 të anketuar kemi vërejtur se 156 të anketuar nga shkollat private të AML (që përfaqësojnë 100% të nxënësve të anketuar nga shkollat private) kanë deklaruar se shkollat e tyre kanë ueb-faqe zyrtare.

Bazuar në anketimet e bëra me 394 nxënës të shkollave publike të AML në Kosovë rezulton që shkollat publike të AML në Kosovë nuk kanë pothuajse fare platformë komunikimi shtëpi-shkollë përmes ueb-faqeve zyrtare. Po ashtu në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 nuk është paraparë që të zhvillohet ndonjë projekt për zhvillimin e ueb-faqeve të shkollave.

Bazuar në rezultatet e lartëcekura të hulumtimit mund të konkludojmë se hipotezat H1 dhe H2 janë vërtetuar.

Në lidhje me ndikimin e ueb-faqeve të shkollave në motivimin e nxënësve bazuar në rezultatet e anketimit me prindër rezulton që 100% e të anketuarve konkludojnë se ka efekt pozitiv. Nga anketimi me nxënës të shkollave publike 85% e të anketuarve mendojnë se ueb-faqja do të kishte efekt pozitiv në motivimin e tyre, 13% mendojnë se do të kishte efekt negativ si dhe 2% nuk kane ndonjë vlerësim rreth efektit të mundshëm në motivimin e tyre. Nga anketimi me nxënës të shkollave private 41% e të anketuarve kanë deklaruar se ueb-faqja ka efekt pozitiv

në motivimin e tyre, 4% kanë deklaruar se ka efekt negativ ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve nuk kanë dhënë ndonjë vlerësim për efektin e ueb-faqeve në motivimin e tyre.

Bazuar në këto rezultate në lidhje me ndikimin e komunikimit përmes ueb-faqeve të shkollave në motivimin e nxënësve mund të konkludojmë se vërtetohet hipoteza H3.

Nga rezultatet e anketimit me prindër lidhur me ndikimin e ueb-faqeve zyrtare në përmirësimin e komunikimit nxënës-mësimdhënës-prind konkludojmë se 100% e tyre janë deklaruar se ka efekt pozitiv. Ndërsa nga anketimi me nxënës të shkollave publike 83% e të anketuarve mendojnë se ueb-faqja do të kishte efekt pozitiv në përmirësimin e komunikimit nxënës-mësimdhënës-prind, 21% mendojnë se do të kishte efekt negativ si dhe 14% nuk kanë ndonjë vlerësim rreth efektit të mundshëm në motivimin e tyre. Gjithashtu nga anketimi me nxënës të shkollave private 28% e të anketuarve deklaruan se ueb-faqja ka efekt pozitiv në përmirësimin e komunikimit nxënës-mësimdhënës-prind, 12% kanë deklaruar se ka efekt negativ ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve nuk kanë dhënë ndonjë vlerësim për efektin e ueb-faqeve në përmirësimin e komunikimit nxënës-mësimdhënës-prind.

Meqë nga anketimet e bëra nuk ka ndonjë rezultat konkret rreth përfshirjes së prindërve në aktivitetet e shkollës atëherë konkludojmë se hipoteza H4 është vërtetuar pjesërisht dhe mbetet hapësirë për studijues tjerë ta zgjerojnë këtë hulumtim edhe më tutje.

Sa i përket ndikimit të ueb-faqeve të shkollave në ngritjen e nivelit të sigurisë në shkollë, duke u bazuar në rezultatet e anketimit me prindër rezulton që 95% e të anketuarve konkludojnë se ka efekt pozitiv ndërsa 5% e tyre mendojnë se ka efekt negativ. Nga anketimi me nxënës të shkollave publike 72% e të anketuarve mendojnë se ueb-faqja do të kishte efekt pozitiv në ngritjen e nivelit të sigurisë në shkollë, 6% mendojnë se do të kishte efekt negativ si dhe 23% nuk kanë ndonjë vlerësim rreth efektit të mundshëm. Nga anketimi me nxënës të shkollave private 43% e të anketuarve mendojnë se ueb-faqja ka efekt pozitiv në ngritjen e nivelit të sigurisë në shkollë, 6% kanë deklaruar se ka efekt negativ ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve nuk kanë dhënë ndonjë vlerësim për efektin e ueb-faqeve në ngritjen e nivelit të sigurisë në shkollë.

Bazuar në këto rezultate në lidhje me ndikimin e komunikimit përmes ueb-faqeve të shkollave në ngritjen e nivelit të sigurisë në shkollë mund të konkludojmë se vërtetohet hipoteza H5.

Lidhur me ndikimin e komunikimit përmes ueb-faqeve zyrtare në stimulimin e arritjes së rezultateve më të larta në mësimnxënie, bazuar në rezultatet e anketimit me prindër rezulton që 95% e të anketuarve konkludojnë se ka efekt pozitiv ndërsa 5% e tyre nuk kanë ndonjë

vlerësim. Nga anketimi me nxënës të shkollave publike 85% e të anketuarve mendojnë se ueb-faqja do të kishte efekt pozitiv në stimulimin e arritjes së rezultateve më të larta në mësimnxënie, 4% mendojnë se do të kishte efekt negativ si dhe 12% nuk kanë ndonjë vlerësim rreth efektit të mundshëm.

Nga rezultatet e lartpërmendura në lidhje me ndikimin e komunikimit përmes ueb-faqeve të shkollave në stimulimin e arritjes së rezultateve më të larta në mësimnxënie mund të konkludojmë se vërtetohet hipoteza H6.

Nga rezultatet e këtij hulumtimi vërehet se shkollat publike të AML në Kosovë kanë mungesë të ueb-faqeve zyrtare ndërsa ato private qëndrojnë më mirë në këtë aspekt.

4.2. Rekomandimet

Duke u bazuar në konkluzionet e nxjerra nga hulumtimet e bëra përmes anketimeve me prindër dhe nxënës të shkollave të AML në Republikën e Kosovës si dhe nga hulumtimet e bëra në internet duke i analizuar ueb-faqet e shkollave dhe përmbajtjet e tyre rekomandojmë që për shkollat publike të AML të krijohen ueb-faqet e shkollave për ta përmirësuar dhe lehtësuar komunikimin shtëpi-shkollë dhe për përfshirjen e prindërve në këtë komunikim efektiv. Kjo do të mund të arrihej me iniciativë nga organet qendrore qeveritare apo edhe me vetëiniciativë të shkollave. Krijimi i ueb-faqeve të shkollave publike do të ndikonte në ngritjen e motivimit të nxënësve për të mësuar dhe do ta përmirësonte komunikimin nxënës-mësimdhënës-prind.

Shumica e shkollave private të AML kanë ueb-faqe të shkollës. Ka ende hapësirë që këto ueb-faqe të avancohen për t'i përmbushur nevojat e kohës. Do të kishim sugjeruar që shkollat private të AML në ueb-faqet e tyre t'u japin qasje me përdorues dhe fjalëkalim mësimdhënësve në mënyrë që ata të kenë mundësi për publikim të materialeve të ndryshme mësimore, t'u caktojnë detyra dhe projekte nxënësve dhe ta kenë mundësinë e monitorimit të angazhimit të nxënësve të tyre në detyrat e dhëna. Rekomandojmë që edhe prindërit të kenë qasje të veçantë me përdorues dhe fjalëkalim në ueb-faqen e shkollës për të pasë mundësi të leximit të njoftimeve të shkollës që nuk janë publike për opinionin e gjerë, për komunikim me prindërit tjerë apo dhe stafin e shkollës dhe për monitorimin e suksesit dhe vijueshmërisë së fëmijëve të tyre në shkollë. Gjithashtu rekomandojmë që edhe nxënësit të kenë qasje me përdorues dhe fjalëkalim në ueb-faqen e shkollës në mënyrë që të mund të angazhohen në projektet dhe

detyrat e dhëna nga mësimdhënësit, të komunikojnë me nxënësit tjerë të shkollës dhe mësimdhënësit e tyre.

Rekomandojmë që në ueb-faqet e shkollave të ketë më shumë publikime të materialeve elektronike për lexim. Kjo i mundëson nxënësve qasje më të lehtë për lexim nga pajisje të ndryshme kompjuterike dhe teknologjisë mobile. Pra rekomandojmë që të zhvillohet më shumë komponenta e mësimit elektronik që i ofron nxënësve fleksibilitet në mësimnxënje.

Gjithashtu rekomandojmë që informatat e publikuara në ueb-faqe të shkollave të jenë të sakta dhe të përditësuara për t'i informuar drejtë dhe në kohë përdoruesit e ueb-faqes së shkollës.

BIBLIOGRAFIA

- Al-Debei, M. M. (2014, February 14). The quality and acceptance of websites: an empirical investigation in the context of higher education. *Int. J. Business Information Systems*, 15(2), 170-188. Gjetur 03 17, 2020, nga <https://www.inderscienceonline.com/doi/abs/10.1504/IJBIS.2014.059252?journalCode=ijbis>
- Álvarez, C. Á., & Inés-García, J. (2017, November 10). The management of schools' websites in Cantabria, Spain. *Research in Learning Technology*, 25(1), 1-13. doi:10.1080/21567069.2017.1270579
- Baghdadi, Z. D. (2011, July). Best Practices In Online Education: Online Instructors, Courses, And Administrators. *Turkish Online Journal of Distance Education*, 12(3), 109-117. Gjetur 03 28, 2020, nga <https://eric.ed.gov/contentdelivery/servlet/ERICServlet?accno=EJ965061>
- Bilgic, H. G., & Tuzun, H. (2019, November 01). Issues and Challenges with Web-Based Distance Education Programs in Turkish Higher Education Institutes. *Turkish Online Journal of Distance Education*, 21(1), 143-164. Gjetur 03 19, 2020, nga <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1238994.pdf>
- Chow, A. S., Smith, K. M., & Sun, K. (2012, December 29). Youth as Design Partners: Age-Appropriate Websites for Middle and High School Students. *Journal of Educational Technology & Society*, 15(4), 89-103. Gjetur 03 20, 2020, nga <https://web.a.ebscohost.com/ehost/pdfviewer/pdfviewer?vid=18&sid=3cce8f2e-42e7-4edd-82cd-9c1c7c7340b8%40sessionmgr4007>
- Galovicova, T., Kremenova, I., & Fabus, J. (2017, September 26). Usability Evaluation of University Websites. *European Journal of Higher Education IT*, 1-9. Gjetur 03 22, 2020, nga https://www.eunis.org/download/2017/EUNIS_2017_paper_10.pdf
- Gu, L. (2017, June 31). Using school websites for home-school communication and parental involvement? *Nordic Journal of Studies in Educational Policy*, 3(2), 133-143. doi:10.1080/20020317.2017.1338498
- Houri, A. K., Thayer, A. J., & Cook, C. R. (2019, July). Targeting Parent Trust to Enhance Engagement in a School-Home Communication System: A Double-Blind Experiment of a Parental Wise Feedback Intervention. *American Psychological Association*, 34(4), 421-432. Gjetur 04 02, 2020, nga <https://psycnet.apa.org/doiLanding?doi=10.1037%2Fspq0000318>
- Huss, J. A. (2019). Middle Level Education Aims for Equity and Inclusion, but Do Our School Websites Meet ADA Compliance? *Middle Grades Review*, 5(1), 1-10. Gjetur 04 12, 2020, nga <https://eric.ed.gov/?id=EJ1214821>
- Jurkowski, O. (2018). School Library Website Components. *TechTrends: Linking Research & Practice to Improve Learning*, 48(6), 56-60. doi:10.1007/BF02763586

- Karacaoglu, Ö. C. (2018, March 22). Curriculum Evaluation in Online Education: The Case of Teacher Candidates Preparing Online for Public Personnel Selection Examination. *International Journal of Higher Education*, 7(2), 107-120. Gjetur 04 04, 2020, nga <https://eric.ed.gov/?id=EJ1173611>
- Kraft, M. A. (2017, September). Engaging parents through: better communication systems. *Engaging parents through: better communication systems*, 75(1), fv. 58-62. Gjetur 03 24, 2020, nga <https://web.a.ebscohost.com/ehost/pdfviewer/pdfviewer?vid=13&sid=1838d9e9-b471-4976-b7d6-c489b9596b8c%40sessionmgr4007>
- Kuusimäki, A.-M., Uusitalo-Malmivaara, L., & Tirri, K. (2019, November 14). The Role of Digital School-Home Communication in Teacher Well-Being. (P. Y. Wong , Re.) *Frontiers Research Foundation*, 10, 1-8. doi:10.3389/fpsyg.2019.02257
- Laho, N. S. (2019). Enhancing School-Home Communication through Learning Management System Adoption: Parent and Teacher Perceptions and Practices. *School Community Journal*, 29(1), 117-142. Gjetur 03 21, 2020, nga <https://eric.ed.gov/?id=EJ1219893>
- Lim, C. P., Zhao, Y., Tondeur, J., Chai, C. S., & Tsai, C.-C. (2013, April). Bridging the Gap: Technology Trends and Use of Technology in Schools. *Journal of Educational Technology & Society*, 16(2), 59-68. Gjetur 03 27, 2020, nga <https://web.a.ebscohost.com/ehost/pdfviewer/pdfviewer?vid=20&sid=1838d9e9-b471-4976-b7d6-c489b9596b8c%40sessionmgr4007>
- Lo, H.-J., Fu, G.-L., & Chuang, K.-C. (2013, October). Needs of the learning effect on instructional website for vocational high school students. *The Turkish Online Journal of Educational Technology*, 12(4), 113-123. Gjetur 04 10, 2020, nga <https://eric.ed.gov/?id=EJ1018035>
- McKenzie , T., & D, K. (2019, January). School websites: A physical education and physical activity content analysis. *Journal of School Health*, 90(1), 47-55. Gjetur 03 30, 2020, nga <https://web.a.ebscohost.com/ehost/detail/detail?vid=27&sid=1838d9e9-b471-4976-b7d6-c489b9596b8c%40sessionmgr4007&bdata=JnNpdGU9ZWZWhvc3QtbGl2ZQ%3d%3d#db=eric&AN=EJ1236714>
- Meyer, K. A., & Wilson, J. L. (2011). The Role of Online Learning in the Emergency Plans of Flagship Institutions. *Online Journal of Distance Learning Administration*, 14(1). Gjetur 04 06, 2020, nga https://www.westga.edu/~distance/ojdl/spring141/meyer_wilson141.html
- Ministria e Arsimit, S. T. (2018, 04 27). *Divizioni për Arsim Privat Parauniversitar*. Gjetur 04 21, 2020, nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit: <https://masht.rks-gov.net/divizioni-per-arsim-privat-parauniversitar>
- Negrete, J. (2017, December 18). *Blooming Relationships: Increasing Communication Between Parents and Teachers*. Gjetur 04 05, 2020, nga Digital Commons: https://digitalcommons.csumb.edu/caps_thes_all/202/
- Piper, T. (2012, Nov/Dec). Using school websites to support parent engagement. 42(2), fv. 36-38. Gjetur 03 20, 2020, nga <https://eric.ed.gov/?id=EJ989780>

- Prougestaporn, P., Visansakon, T., & Saowapakpongchai, K. (2015, March). Key Success Factors and Evaluation Criterias of e-Learning Websites for Higher Education. *International Journal of Information and Education Technology*, 5(3), 233-236. doi:10.7763/IJiet.2015.V5.507
- Rotem, D., & Oster-Levinz, D. (2007, July 14). The school website as a virtual learning environment. *The Turkish Online Journal of Educational Technology*, 6(3), 1-12. Gjetur 03 12, 2020, nga <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED500051.pdf>
- Salvador, P., & Rocha, Á. (2014, March). *An Assessment of Content Quality in Websites of Basic and Secondary Portuguese Schools* (Völl. i 1). Springer, Cham. doi:10.1007/978-3-319-05951-8_8
- Stone, C., & Springer, M. (2019, Jul). Interactivity, Connectedness and 'Teacher-Presence': Engaging and Retaining Students Online. *Australian Journal of Adult Learning*, 59(2), 146-169. Gjetur 03 23, 2020, nga <https://eric.ed.gov/?id=EJ1235966>
- Taddeo, C., & Barnes, A. (2016, March). The school website: Facilitating communication engagement and learning. *British Journal of Educational Technology Vol 47 No 2*, 47(2), 421-436. doi:10.1111/bjet.12229
- Tavas,, D., Nazor, V., & Bilac, S. (2011). School Websites: A Possibility of cooperation with parents? *Metodicki obzori*, 6(2), 23-33. Gjetur 04 07, 2020, nga https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=106122
- Tupas, A. B. (2015, October 25). Design and Development of LPU-B High School Website. *Asia Pacific Journal of Multidisciplinary Research*, 3(5), 101-103. Gjetur 03 17, 2020, nga <http://www.apjmr.com/wp-content/uploads/2016/04/APJMR-2015-3.5.3.11.pdf>

SHTOJCA I

Pyetësor: Përdorimi i ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve

Rast studimi: Shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë

Ky pyetësor është përpiluar nga Arjeta Ramadani për qëllime të hulumtimit shkencorë për mbrojtjen e Temës së studimeve Master në fushën e Implementimit të Teknologjisë së Informimit dhe komunikimit (TIK) në Edukim pranë Fakultetit të Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore në Universitetin e Evropës Juglindore - SEEU. Të dhënat në këtë pyetësor do të përdoren vetëm për këtë qëllim dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera.

Pyetësori duhet plotësuar nga prindërit e nxënësve të Shkollave të Mesme të Larta në Kosovë (Klasa 10-12) dhe në rast se prindi ka më shumë se një fëmijë në shkollë atëherë pyetësori duhet të plotësohet veçmas për secilin fëmijë.

Ju falënderoj për kohën tuaj që po e ndani për plotësimin e këtij pyetësori.

Posta elektronike (E-mail) _____ *

1. Në çfarë shkolle vijon mësimin fëmija i juaj? *

- ☐ Shkollë publike
- ☐ Shkollë private

2. Në cilën klasë vijon mësimin fëmija i juaj? *

- ☐ Klasën e 10-të
- ☐ Klasën e 11-të
- ☐ Klasën e 12-të

3. A ka shkolla e fëmijës tuaj ueb-faqe zyrtare? *

- ☐ Po (plotëso vetëm pyetjet 4-9).
- ☐ Jo (plotëso vetëm pyetjet 10-15).

Shkolla e fëmijës tim ka ueb-faqe zyrtare

4. Sa shpesh e vizitoni ueb-faqen e shkollës së fëmijës tuaj? *

- ☐ Çdo ditë
- ☐ Një ose dy herë në javë
- ☐ 1-3 herë në muaj
- ☐ Asnjëherë

5. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme për fëmijën tuaj nga shkolla? *

	Gjithmonë	Shpesh	Rrallë	Asnjëherë
Postë elektronike (e-mail)	☐	☐	☐	☐
Dërgesave me postë	☐	☐	☐	☐
Letra të dërguara nga mësimdhënësi përmes fëmijës	☐	☐	☐	☐
Mediat sociale (facebook, instagram, twitter etj)	☐	☐	☐	☐
Thirrjeve telefonike nga shkolla	☐	☐	☐	☐
Ueb-faqja e shkollës	☐	☐	☐	☐

6. Cilat nga elementet e mëposhtme i përmban ueb-faqja e shkollës së fëmiut tuaj? *

	Po	Jo
Informata rreth historikut të shkollës	☐	☐
Lajme dhe njoftime	☐	☐
Kalendari i aktiviteteve	☐	☐
Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për nxënësit	☐	☐
Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për prindërit	☐	☐
Mësim elektronik (e-learning)	☐	☐
Kontaktet e personelit të shkollës	☐	☐
Qasje në suksesin e nxënësve	☐	☐

7. Komunikimi përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës ka ndikuar në: *

	Pozitivisht	Negativisht	Asnjëra
Motivimin e nxënësit	☐	☐	☐
Përmirësimin e komunikimit prind-mësimdhënësi	☐	☐	☐
Informimin rreth aktiviteteve të shkollës	☐	☐	☐
Rritjen e sigurisë në shkollë	☐	☐	☐
Suksesin dhe shkallën e mësim-nxënies	☐	☐	☐

8. Si ka ndikuar komunikimi me shkollën përmes ueb-faqes zyrtare në aspektin e menaxhimit të kohës? *

- ☐ Ueb-faqja më ka kursyer shumë kohë
- ☐ Komunikimi përmes ueb-faqes më ka harxhuar shumë kohë

9. Në përgjithësi si e vlerësoni ueb-faqen e shkollës së fëmijës tuaj? *

	Shumë mirë	Mirë	Nevojitet përmirësim
Informacionet në dispozicion	☐	☐	☐
Gjetja e lehtë e informatave	☐	☐	☐
Përshtypja e përgjithshme rreth ueb-faqes së shkollës	☐	☐	☐

Shkolla e fëmijës tim nuk ka ueb-faqe zyrtare

10. A mendoni se është e nevojshme që shkolla e fëmijës tuaj të ketë një ueb-faqe zyrtare? *

- ☐ Po, definitivisht
- ☐ Jo, nuk është e nevojshme

11. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme për fëmijën tuaj nga shkolla? *

	Gjithmonë	Shpesh	Rrallë	Asnjëherë
Postë elektronike (e-mail)	☐	☐	☐	☐
Dërgesave me postë	☐	☐	☐	☐
Letra të dërguara nga mësimdhënësi përmes fëmiut	☐	☐	☐	☐
Mediat sociale (facebook, instagram, twitter etj)	☐	☐	☐	☐
Thirrjeve telefonike nga shkolla	☐	☐	☐	☐
Ueb-faqja e shkollës	☐	☐	☐	☐

12. Çka mendoni, cilat nga elementet e mëposhtme duhet t'i përmbajë ueb-faqja e shkollës së fëmiut tuaj? *

	Po	Jo
Informata rreth historikut të shkollës	☐	☐
Lajme dhe njoftime	☐	☐
Kalendari i aktiviteteve	☐	☐
Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për nxënësit	☐	☐
Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për prindërit	☐	☐
Mësim elektronik (e-learning)	☐	☐
Kontaktet e personelit të shkollës	☐	☐
Qasje në suksesin e nxënësve	☐	☐

13. Në rast se shkolla e fëmijës tuaj do të krijojë një ueb-faqe zyrtare, si do ta vlerësonit ndikimin e sajë në: *

	Pozitivisht	Negativisht	Asnjëra
Motivimin e nxënësit	☐	☐	☐
Përmirësimin e komunikimit prind-mësimdhënësi	☐	☐	☐
Informimin rreth aktiviteteve të shkollës	☐	☐	☐
Rritjen e sigurisë në shkollë	☐	☐	☐
Suksesin dhe shkallën e mësim-nxënies	☐	☐	☐

14. A mendoni se komunikimi online me shkollën do të kishte efekt pozitiv në menaxhimin e kohës? *

- ☐ Po, do ta kursente shumë kohën
- ☐ Jo, do të kishim humbur më shumë kohë për të komunikuar me shkollën

15. Si do ta vlerësonit në përgjithësi komunikimin me shkollën përmes ueb-faqes? *

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
Vlerësim i ulët	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	Vlerësim i lartë

SHTOJCA II

Përdorimi i ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve. Rast studimi: Shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë

Ky pyetësor është përpiluar nga Arjeta Ramadani për qëllime të hulumtimit shkencorë për mbrojtjen e Temës së studimeve Master në fushën e Implementimit të Teknologjisë së Informimit dhe komunikimit (TIK) në Edukim pranë Fakultetit të Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore në Universitetin e Evropës Juglindore - SEEU. Të dhënat në këtë pyetësor do të përdoren vetëm për këtë qëllim dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera.

Pyetësori duhet të plotësohet nga nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta në Kosovë (Klasa 10-12).

Ju falënderoj për kohën tuaj që po e ndani për plotësimin e këtij pyetësori.

I. Në cilën klasë vijoni mësimin? * *(Plotëso vetëm një përgjigje.)*

- ☐ Klasën e 10-të
- ☐ Klasën e 11-të
- ☐ Klasën e 12-të

II. Në çfarë shkolle vijoni mësimin? * *(Plotëso vetëm një përgjigje.)*

- ☐ Shkollë publike (shtetërore)
- ☐ Shkollë private

Pyetjet për shkollat që nuk kanë ueb-faqe zyrtare

1. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme nga shkolla? *

Plotëso vetëm njërin në çdo rresht.

	Gjithmonë	Shpesh	Rrallë	Asnjëherë
Postë elektronike (e-mail)	☐	☐	☐	☐
Dërgesave me postë	☐	☐	☐	☐
Letra të dërguara nga mësimdhënësi përmes fëmijës	☐	☐	☐	☐
Mediat sociale (facebook, instagram, twitter etj)	☐	☐	☐	☐
Thirrjeve telefonike nga shkolla	☐	☐	☐	☐
Ueb-faqja e shkollës	☐	☐	☐	☐

2. A mendoni se është e nevojshme që shkolla e juaj të ketë një ueb-faqe zyrtare? *

Plotëso vetëm një përgjigje.

- ☐ Po, definitivisht
- ☐ Jo, nuk është e nevojshme

3. A do ta kishit shfrytëzuar ueb-faqen e shkollës për t'u konsultuar me mësimdhënësit rreth çështjeve mësimore? *

Plotëso vetëm një përgjigje.

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Ndoshta

4. Çka mendoni, cilat nga elementet e mëposhtme duhet t'i përmbajë ueb-faqja e shkollës tuaj? *

Plotëso vetëm njërën në çdo rresht.

	Po	Jo
Informata rreth historikut të shkollës	☐	☐
Lajme dhe njoftime	☐	☐
Kalendari i aktiviteteve	☐	☐
Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për mësime	☐	☐
Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për nxënësit	☐	☐
Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për prindërit	☐	☐
Mësim elektronik (e-learning)	☐	☐
Kontaktet e personelit të shkollës	☐	☐
Qasje nga prindërit dhe nxënësit në suksesin dhe vijueshmërinë	☐	☐
Materiale mësimi (libra elektronik, video, e-librari)	☐	☐
Informata rreth historikut të shkollës	☐	☐

5. Ne rast se shkolla juaj do të krijojë një ueb-faqe zyrtare, si do ta vlerësonit ndikimin e sajë në: * (Plotëso vetëm njërën në çdo rresht.)

	Pozitivisht	Negativisht	Asnjëra
Përmirësimin e komunikimit me mësime	☐	☐	☐
Informimin rreth aktiviteteve të shkollës	☐	☐	☐
Rritjen e sigurisë në shkollë	☐	☐	☐
Suksesin dhe shkallën e mësim-nxënies	☐	☐	☐

6. A mendoni se komunikimi online me shkollën do të kishte efekt pozitiv në menaxhimin e kohës? * (Plotëso vetëm një përgjigje.)

- ☐ Po, do ta kursente shumë kohën
☐ Jo, do të kishim humbur më shumë kohë për të komunikuar me shkollën

7. Komunikimi përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës a do t'iu kishte stimuluar që të keni arritje më të lartë në mësim-nxënie? * (Plotëso vetëm një përgjigje.)

- ☐ Po
☐ Jo

8. Si do ta vlerësonit ndikimin e ueb-faqes zyrtare të shkollës në motivimin tuaj? *
 Plotëso vetëm një përgjigje.

- ☐ Pozitiv
☐ Negativ
☐ Asnjëra

9. Si do ta vlerësonit ndikimin e komunikimit mësime-prind-nxënës përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës në suksesin tuaj në mësim? * (Plotëso vetëm një përgjigje.)

- ☐ Pozitiv
☐ Negativ
☐ Asnjëra

10. Si do ta vlerësonit në përgjithësi komunikimin me shkollën përmes ueb-faqes? *

*Plotëso vetëm një përgjigje.

Aspak	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Shkëlqyeshëm
	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	

SHTOJCA III

Përdorimi i ueb-faqeve të shkollave si platformë e komunikimit shtëpi-shkollë dhe përfshirjes së prindërve. Rast studimi: Shkollat e Arsimit të Mesëm të Lartë në Kosovë

Ky pyetësor është përpiluar nga Arjeta Ramadani për qëllime të hulumtimit shkencorë për mbrojtjen e Temës së studimeve Master në fushën e Implementimit të Teknologjisë së Informimit dhe komunikimit (TIK) në Edukim pranë Fakultetit të Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore në Universitetin e Evropës Juglindore - SEEU. Të dhënat në këtë pyetësor do të përdoren vetëm për këtë qëllim dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera.

Pyetësi duhet të plotësohet nga nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta në Kosovë (Klasa 10-12).

Ju falënderoj për kohën tuaj që po e ndani për plotësimin e këtij pyetësi.

III. Në cilën klasë vijoni mësimin? * (Plotëso vetëm një përgjigje.)

- ☐ Klasën e 10-të
- ☐ Klasën e 11-të
- ☐ Klasën e 12-të

IV. Në çfarë shkolle vijoni mësimin? * (Plotëso vetëm një përgjigje.)

- ☐ Shkollë publike (shtetërore)
- ☐ Shkollë private

Pyetjet për shkollat që kanë ueb-faqe zyrtare

1. Ju lutem shënojeni adresën (linkun) e ueb-faqes së shkollës suaj? *

www._____

2. Sa shpesh e vizitoni ueb-faqen e shkollës? *

Plotëso vetëm një përgjigje.

- ☐ Çdo ditë
- ☐ Një ose dy herë në javë
- ☐ 1-3 herë në muaj
- ☐ Asnjëherë

3. Çfarë informata merrni më shpesh nga ueb-faqja e shkollës suaj? *

Plotëso ato që vlejnë.

- ☐ Njoftime rreth aktiviteteve mësimore në shkollë
- ☐ Njoftime rreth aktiviteteve organizative të shkollës (vizita, shëtitje etj.)
- ☐ Informata rreth suksesit (notave) dhe mungesave në shkollë
- ☐ Materiale mësimore për lexim

4. Çka mendoni se i mungon ueb-faqes së shkollës suaj? *

Plotëso ato që vlejnë.

- ☐ Informatat kontaktuese
- ☐ Qasja e mësimdhënësve me përdorues dhe fjalëkalim (ang. user and password)
- ☐ Qasja e nxënësve me përdorues dhe fjalëkalim
- ☐ Qasja e prindërve me përdorues dhe fjalëkalim

- ☐ Publikimi i materialeve mësimore elektronike për mësim
- ☐ Dizajni i ueb-faqes nuk është i lehtë në përdorim (ang. user friendly)
- ☐ Asnjëra më lartë

5. Në çfarë forme i pranoni informacionet e përgjithshme nga shkolla? *

Plotëso vetëm njërën në çdo rresht.

	Gjithmonë	Shpesh	Rrallë	Asnjëherë
Postë elektronike (e-mail)	☐	☐	☐	☐
Dërgesave me postë	☐	☐	☐	☐
Letra të dërguara nga mësimdhënësi përmes nxënësit	☐	☐	☐	☐
Mediat sociale (facebook, instagram, twitter etj)	☐	☐	☐	☐

6. Cilat nga elementet e mëposhtme i përmban ueb-faqja e shkollës suaj? *

Plotëso vetëm njërën në çdo rresht.

	Po	Jo
Informata rreth historikut të shkollës	☐	☐
Lajme dhe njoftime	☐	☐
Kalendari i aktiviteteve	☐	☐
Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për mësimdhënësit	☐	☐
Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për nxënësit	☐	☐
Qasje me përdorues (user) dhe fjalëkalim (password) për prindërit	☐	☐
Mësim elektronik (e-learning)	☐	☐
Kontaktet e personelit të shkollës	☐	☐
Qasje nga prindërit dhe nxënësit në suksesin dhe vijueshmërinë	☐	☐

7. A e shfrytëzoni ueb-faqen e shkollës për t'u konsultuar me mësimdhënësit rreth çështjeve mësimore? *

Plotëso vetëm një përgjigje.

- ☐ Po
- ☐ Jo

8. Komunikimi përmes ueb-faqes zyrtare të shkollës ka ndikuar në: *

Plotëso vetëm njërën në çdo rresht.

	Pozitivisht	Negativisht	Asnjëra
Motivimin e juaj	☐	☐	☐
Përmirësimin e komunikimit me mësimdhënësin	☐	☐	☐
Informimin rreth aktiviteteve të shkollës	☐	☐	☐
Rritjen e sigurisë në shkollë	☐	☐	☐

9. Sa mendoni se ueb-faqja i plotëson nevojat e kohës? *

Plotëso vetëm një përgjigje.

	1	2	3	4	5	
Aspak	☐	☐	☐	☐	☐	Shkëlqyeshëm

10. Ne përgjithësi si e vlerësoni ueb-faqen e shkollës suaj? *

Plotëso vetëm njërën në çdo rresht.

	Shumë mirë	Mirë	Nevojitet përmirësim
Informacionet në dispozicion	☐	☐	☐
Gjetja e lehtë e informatave	☐	☐	☐
Përshtypja e përgjithshme rreth ueb-faqes së shkollës	☐	☐	☐